# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5805
E mërkurë, 19 qershor 2019
çmimi 0.40 €


## Kodi telefonik shtetëror +383 ende nuk është duke u zbatuar plotësisht

FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


FLET PËR "EPOKËN E RE", ISMAJL KURTESHI FAQE 4-5

# Shqiptarët e Luginës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë



## - Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerrë rezolutë për të drejtat e shqiptarëve të Luginës

Kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ismajl Kurteshi, ka treguar për diskriminimin e rëndë të shqiptarëve të Luginës së Preshevës pas vizitës së këtij komisioni atje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se shqiptarët e Luginës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë. Kurteshi ka bërë me dije se Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerrë një rezolutë nëpërmjet së cilës, në dialogun që po zhvillohet në Bruksel, të adresohen kërkesat kryesore të shqiptarëve të asaj pjese. Sipas tij, kërkesa e tyre kryesore është përfshirja e çështjes së Luginës së Preshevës në bisedimet përfundimtare Kosovë - Serbi

## Haradinaj: Konkluzionet e Këshillit të BE-së nuk e zbehin liberalizimin e vizave



Kryeministri Ramush Haradinaj ka vlerësuar se procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës nuk është zbehur, por është avancuar. Ai ka thënë të martën, në një konferencë për media, se po interpretohen gabimisht konkluzionet e Këshillit të BE-së në lidhje me liberalizimin e vizave. Sipas Haradinajt, nuk ka ende vendim për liberalizim, as kritere shtesë, por ka vetëm disa konkluzione. Këto komente kryeministri Haradinaj i ka bërë pas mbledhjes së qeverisë, me ç'rast ka komentuar konkluzionet e dala nga takimi i Këshillit të BE-së FAQE 3

## Ministria e Shëndetësisë shënon përparim në raportin vjetor të auditimit

FAQE 7



## OPINION

### MJAFT INTERPRETIME POLITIKE! PRESIDENTI ËSHTË I REPUBLIKËS, REPUBLIKA ËSHTË E QYTETARËVE F. 11

Shkruan:
Prof. Lisen BASHKURTI



## AKTUALE

### HYN NË FUQI MARRËVESHJA E EKSTRADIMIT NË MES TË KOSOVËS DHE SHBA-së F. 6

### SHSKUK-JA LEHTËSON SHËRBIMET PËR TË MBIJETUARAT NGA DHUNA SEKSUALE GJATË LUFTËS NË KOSOVË F. 6

## EKONOMI



### FUNKSIONALIZIMI I DHOMËS SË POSAÇME ZHBLLOKON 20-PËRQINDËSHIN E MIJËRA PUNËTORËVE F.9

### AEROPORTI 'ADEM JASHARI' SË SHPEJTI DO TË BËHET ME NJË AEROPLAN TË RI F.8

## SPORT

### SHORT I PAMËSHIRSHËM PËR FERONIKELIN DHE PRISHTINËN F. 16


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Soreca: Partitë duhet kapërcyer situatën e tanishme politike

TIRANË, 18 QERSHOR- Ambasadori i Bashkimit Evropian në Tiranë, Luigi Soreca tha të martën se Këshilli Evropian riafirmoi angazhimin për hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.
Soreca në reagimin e tij, thekson se duhet të rinisë urgjentisht dialogu me të gjitha partitë politike për të kapërcyer situatën politike në vend, duke vënë në dukje se është koha për t'u përqendruar te procesi i reformave. "Këshilli Evropian ka riafirmuar sot angazhimin e saj për hapjen e negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Në pikëpamje të tetorit të ardhshëm "vendim i qartë dhe substancial" nga Këshilli, tani është koha që të gjitha institucionet të vazhdojnë të përqendrohen në procesin e reformave, në veçanti në reformën në drejtësi dhe për të rinisur urgjentisht një dialog me të gjitha partitë për të kapërcyer situatën e tanishme politike, për të siguruar që Shqipëria të mund të vazhdojë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE dhe të shkojë në hapin e ardhshëm. Nuk ka kohë për të humbur", tha Soreca.



# Negociatat me Shqipërinë nuk hapen, vendimi në tetor

Ministrat e jashtëm të BE-së nuk arritën të vendosin lidhur me hapjen e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë dhe vendimi do të shtyhet për në muajin tetor, meqë Gjermania është në pritje të vlerësimit të Parlamentit të saj, ndërsa disa vende skeptike si Franca dhe Holanda nuk janë të gatshme për një vendim të shpejtë




TIRANË, 18 QERSHOR - Ministrat e jashtëm të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian nuk arritën të martën të marrin një vendim lidhur me rekomandimin e Komisionit Evropian për hapjen e bisedimeve të anëtarësimit me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut.
Komisionari për Zgjerimin, Johannes Hahn, tha se ndihej i keqardhur që disa nga vendet anëtare nuk e mbështetën propozimin e qartë të Komisionit. Sipas tij, të dy vendet duhet të ishin shpërblyer pasi ato kishin përmbushur çfarë u ishte kërkuar vitin e shkuar.
Sipas të gjitha gjasave, vendimi për bisedimet do të shtyhet për në vjeshtë, në muajin tetor, duke qenë se Gjermania është në pritje të vlerësimit të Parlamentit të saj, ndërsa disa vende skeptike si Franca dhe Holanda nuk janë të gatshme për një vendim të shpejtë.
Mbetet për t'u parë formulimi me të cilin Këshilli Evropian i 20-21 qershorit do ta shoqërojë shtyrjen e vendimit.
Teksti që krerët e shteteve do të hartojnë mund të ketë rëndësi për të vlerësuar se cila mund të jetë tendenca e qasjes së vendeve anëtare dhe sa realisht të dy vendet ballkanike do të mund të shpresojnë se tetori do të jetë vërtet momenti kur ata do të marrin një datë për hapjen e bisedimeve, pasi dy herë me radhë Komisioni Evropian vlerësoi pozitivisht përparimin e bërë prej tyre.
Në vendimin përfundimtar të Këshillit, për Shqipërinë thuhet: "Duke ripohuar konkluzionet e tij të 26 qershorit 2018, Këshilli konsideron Rekomandimin e Komisionit për të hapur negociatat e pranimit me Shqipërinë, në bazë të vlerësimi për progresin pozitiv të bërë dhe përmbushjen e kushteve të identifikuara nga Këshilli. Si pasojë e kohës së kufizuar në dispozicion, Këshilli do të kthehet në këtë çështje me qëllim që të arrijë një vendim të qartë dhe substancial, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se tetori 2019".
Parlamenti i Gjermanisë e ka shtyrë marrjen e çdo vendimi deri në shtator, ndërsa Dhoma e Ulët e Parlamentit holandez ka hedhur poshtë hapjen e negociatave me Shqipërinë. Duke folur përpara takimit të Luksemburgut që u mbajt pothuajse një vit pas ditës kur BE-ja pezulloi papritur një vendim për hapjen e bisedimeve me dy vendet, ministri gjerman për çështjet e Bashkimit Evropian, Michael Roth, tha se nëse vendi i tij ka pranuar në parim hapjen e negociatave, Bundestagu ka pasur deri më tani shumë pak kohë për t'u marrë si duhet me raportin.
Një zhvillim tjetër që po e ndërlikon më tej çështjen është se Qiproja ka kërcënuar t'i vërë veton çdo marrëveshjeje, nëse BE-ja nuk përballet me Turqinë lidhur me shpimet në ujërat territoriale qipriote në Mesdhe.
Ministri i Jashtëm italian Enzo Moavero tha se ministrat e jashtëm të bllokut tashmë kanë rënë dakord se në përgjigje të kërkesës së Qipros duhet të merren "masa të mjaftueshme", por që mbeten për t'u shqyrtuar. Ministri i Jashtëm rumun George Ciamba tha se angazhimi në bisedimet me Maqedoninë e Veriut mund të përmirësonte qëndrueshmërinë e rajonit, gjë që ai tha se do të ishte në interesin strategjik të Unionit.

## Betohet ambasadorja amerikane në Maqedoninë e Veriut

UASHINGTON, 18 QERSHOR - Ambasadorja e re e Shteteve të Bashkuara në Maqedoninë e Veriut, Kate Byrnes, u betua të hënën mbrëma në një ceremoni në Departamentin amerikan të Shtetit.
Ndihmës sekretari në detyrë për çështjet e Evropës dhe Euroazisë, Philip Reeker, i cili po ashtu ka shërbyer më parë si ambasador në Shkup, theksoi me këtë rast se ambasadorja Byrnes "do të shënojë një epokë të re në bashkëpunimin e dyanshëm, si miq dhe aleatë me Maqedoninë e Veriut".
Miq, familjarë dhe kolegë të ambasadores Byrnes, dhe disa prej ambasadorëve që kishin shërbyer më parë në Maqedoninë e Veriut, ishin të pranishëm në ceremoni. Byrnes pritet së shpejti të udhëtojë në Shkup për ta marrë detyrën e ambasadores amerikane.
Byrnes u konfirmua në këtë post muajin e kaluar në Senatin amerikan, ndërsa ishte emëruar vitin e kaluar nga presidenti Donald Trump. Ajo është diplomate e karrierës dhe deri tash kishte shërbyer si zëvendësambasadore në Athinë. Më parë, Byrnes kishte shërbyer në Vjenë si përfaqësuese e Misionit të Shteteve të Bashkuara në Organizatën për Siguri e Bashkëpunim në Evropë.
Byrnes do të zëvendësojë ambasadorin e deritashëm në Shkup, Jess Baily.
Byrnes gjatë seancës së konfirmimit muajin e kaluar kishte theksuar se do të jetë e përkushtuar ndaj forcimit të marrëdhënieve me Maqedoninë e Veriut si partnere strategjike, ndërsa kishte theksuar se marrëveshja e Prespës e arritur ndërmjet Shkupit dhe Athinës lidhur me emrin kishte tejkaluar një pengesë historike dhe zbatimi i saj është i rëndësishëm për rajonin.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhjen e radhës

# Haradinaj: Konkluzionet e Këshillit të BE-së nuk e zbehin liberalizimin e vizave



**Kryeministri Ramush Haradinaj ka vlerësuar se procesi i liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës nuk është zbehur, por është avancuar. Ai ka thënë të martën, në një konferencë për media, se po interpretohen gabimisht konkluzionet e Këshillit të BE-së në lidhje me liberalizimin e vizave. Sipas Haradinajt, nuk ka ende vendim për liberalizim, as kritere shtesë, por vetëm disa konkluzione. Këto komente kryeministri Haradinaj i ka bërë pas mbledhjes së qeverisë, me ç'rast ka komentuar konkluzionet e dala nga takimi i Këshillit të BE-së**

EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Kryeministri Ramush Haradinaj e ka quajtur sukses për Kosovën përfshirjen e çështjes së liberalizimit të vizave në konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian (BE). Ai ka vlerësuar se këto konkluzione nuk e kanë zbehur procesin e liberalizimit të vizave, por e kanë avancuar. Madje, sipas Haradinajt, po afrohet dita kur Kosova do ta marrë liberalizimin e vizave. "Deri më tani nuk ka qenë duke u konsideruar marrja e vendimit nga Këshilli. Është hera e parë që kemi mbërritur deri te konkluzionet, pra jo që nuk është zbehur, por po afrohet dita kur do ta marrim lajmin e shumëpritur. Po punojmë për atë", ka deklaruar Haradinaj në një konferencë me gazetarë pas mbledhjes së rregullt të kabinetit qeveritar.

Ai ka thënë se po interpretohen gabimisht konkluzionet e Këshillit të Bashkimit Evropian në lidhje me liberalizimin e vizave. Megjithatë, Haradinaj ka theksuar se nuk ka ende vendime për liberalizimin e vizave, as kritere shtesë, por ka vetëm disa konkluzione. Ai ka thënë se asnjëherë deri më tani Kosova nuk është përmendur në konkluzionet e Këshillit të BE-së për çështjen e vizave. "Propozimi për të marrë një vendim konsiderohet nga Këshilli. Për t'u marrë një vendim duhet hyrë në agjendë. Nuk kemi hyrë në agjendë dhe nuk është marrë vendim. Prandaj nuk është vendim, por janë konkluzione. Jemi në proces. Është me rëndësi që për herë të parë Kosova ka hyrë në konkluzione. Nuk po themi se është kryer sepse i kemi edhe do punë. Por, mos harroni, kemi hyrë në konkluzione dhe duhet të hyjmë edhe në agjendë. Dikush ka thënë se vendimi është negativ, por ne e dimë se vendimi për liberalizimin e vizave do të jetë pozitiv dhe po punojmë për këtë. Është sukses për Kosovën hyrja në konkluzione. Pra, liberalizimi i vizave ka hyrë në konkluzione dhe thotë se Këshilli aktualisht është duke e konsideruar marrjen e vendimit", është shprehur Haradinaj, duke shtuar se nuk ka qenë e lehtë hyrja e Kosovës në këto konkluzione. "Pra, ka qenë bukur punë për të ardhur deri aty, mirëpo mendoj se për të ardhur deri këtu ka ndihmuar sidomos Berlini", ka theksuar Haradinaj.

Duke e komentuar sugjerimin e Këshillit të Ministrave të BE-së për heqjen e taksës ndaj Serbisë dhe Bosnjë e Hercegovinës, Haradinaj ka theksuar se kjo taksë paraqet problem në raportet ndërkombëtare të Kosovës, por nuk ndërlidhet me liberalizimin e vizave, procesin integrues në BE apo me dialogun me Serbinë.

Kryeministri Haradinaj ka thënë se Kosova i ka zbatuar të gjitha kushtet, ndërkohë që taksa nuk përmendet në klauzolën për vizat. "Taksa është një problem në marrëdhëniet me të gjithë, por ne nuk e kemi procesin e dialogut dhe atë të anëtarësimit në BE nuk e kemi të kushtëzuar me taksën. Kosova i ka zbatuar krejt kushtet për liberalizim të vizave dhe në klauzolën për vizat nuk përmendet taksa. Pra, nuk është një problem i ndërlidhur. Është e vërtetë që taksa ka krijuar një atmosferë të caktuar, por nuk është direkt me këtë sepse gjermanët nuk e kanë kushtëzuar as me taksë e as me kurrgjë vendimin e tyre. Franca i ka kushtet e njëjta si Gjermania", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

## Qeveria formon Task-Forcë kundër narkotikëve dhe sigurisë në shkolla

Kabineti qeveritar në mbledhjen e së martës ka filluar fushatën kundër përdorimit të narkotikëve dhe formimit të Task-Forcës kundër narkotikëve dhe sigurisë në shkolla. Qëllimi i formimit të Task-Forcës është parandalimi, luftimi dhe largimi i drogës nga institucionet shkollore.

Ky do të jetë qëllimi primar, ndërkaq synohet përgjithësisht luftimi i drogës në mesin e të rinjve. Task-Forca do t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme që droga të mos jetë e pranishme te të rinjtë.

Qeveria ka miratuar edhe konceptdokumentin për personat e zhdukur i cili synon ta rregullojë statusin e personave të zhdukur dhe familjeve të tyre përmes plotësimndryshimit të legjislacionit që trajton çështjen e personave të zhdukur dhe mbrojtjen e interesit të familjeve të të zhdukurve.

Po në mbledhjen e së martës kabineti qeveritar ka miratuar edhe vendimin për anulimin e vendimit të Qeverisë të datës 11. 06. 2019 për emërimin e sekretarit të përgjithshëm të Ministrisë së Mbrojtjes.

Miratimin e qeverisë e ka marrë edhe vendimi për vazhdimin e afatit për legalizimin e armëve deri në shtator të këtij viti.

Gjithashtu, kabineti qeveritar ka marrë vendim që 24 qershori të jetë Dita Përkujtimore e komunitetit egjiptian. Po ashtu, është aprovuar edhe konceptdokumenti për masat e sigurisë së rrjeteve të sistemeve të informacionit i cili ka për qëllim ngritjen e nivelit të sigurisë së rrjeteve dhe sistemeve të informacionit. Qeveria ka anuluar vendimin 05/105 të datës 28 maj 2019, për shqyrtimin e mëtejmë të kërkesës për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme në Komunën e Prishtinës për nevojat e akomodimit të institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës.

Ndërsa kryeministri Ramush Haradinaj ka kërkuar që të informohet kabineti qeveritar nga ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, rreth pritjeve të gjata në vendkalimin kufitar Kosovë - Shqipëri dhe nga ministri i Financave rreth marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Hungarisë.

Flet për "Epokën e re", Ismajl Kurteshi

# Shqiptarët e Luginës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë

## - Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerrë rezolutë për të drejtat e shqiptarëve të Luginës



**Kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ismajl Kurteshi, ka treguar për diskriminimin e rëndë të shqiptarëve të Luginës së Preshevës pas vizitës së këtij komisioni atje. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se shqiptarët e Luginës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë. Kurteshi ka bërë me dije se Kuvendi i Kosovës duhet të nxjerrë një rezolutë përmes së cilës, në dialogun që po zhvillohet në Bruksel, të adresohen kërkesat kryesore të shqiptarëve të asaj pjese. Sipas tij, kërkesa e tyre kryesore është përfshirja e çështjes së Luginës së Preshevës në bisedimet përfundimtare Kosovë - Serbi**

EPOKA E RE Muhamet KOCI

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Kryetari i Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini, Sport, Inovacion dhe Ndërmarrësi, Ismajl Kurteshi, ka thënë se shqiptarët në Luginën e Preshevës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë. Pas kthimit nga vizita në Luginë të Preshevës, Kurteshi ka bërë me dije se do të mbahet një seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit të Kosovës për shqiptarët e Luginës ku përmes një rezolute do të adresohen kërkesat e tyre. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kurteshi ka deklaruar se çështja e Luginës duhet të bëhet pjesë e dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Është e rëndësishme të ceket se shqiptarët në Luginë të Preshevës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë. Ndërsa askush prej Kosovës dhe prej Shqipërisë nuk e ngre këtë çështje në qarqet e BE-së. Serbia po përparon drejt integrimit në BE pa u vënë re se shteti serb po bën diskriminime që janë të paimagjinueshme se gjëra të tilla mund të ndodhin në Evropë", ka thënë Kurteshi.

Teksa ka folur për diskriminimin e shqiptarëve në Luginë, ai ka thënë se gjendja e atyre është më e rëndë se para katër vjetëve që ky komision kishte vizituar atë pjesë. Sipas tij, shqiptarët e asaj pjese duhet t'i gëzojnë të njëjtat të drejta që i gëzojnë serbët e Kosovës. "Kërkesa e shqiptarëve të Luginës së Preshevës drejtuar atij delegacioni shtetëror është që çështja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës të bëhet pjesë e dialogut Kosovë - Serbi në Bruksel. Shqiptarët kërkojnë reciprocitet në të drejta. Pra, ato të drejta që i gëzojnë serbët në Kosovë duhet t'i gëzojnë edhe shqiptarët në Luginë. Kërkojnë që të zgjidhet çështja e teksteve shkollore dhe të ndodhë njohja e diplomave. Kërkojnë që në universitetet publike të Kosovës të ketë më shumë studentë nga Lugina", ka thënë ai.

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje ka thënë Lugina ka nevojë për mbështetje politike dhe materiale të Kosovës dhe Shqipërisë. "Natyrisht, kërkojnë që Kosova dhe Shqipëria të investojnë në projekte të ndryshme në komunat ku jetojnë shqiptarët sepse, siç thanë ata, nëse Serbia mund të investojë nga 500-600 milionë euro për serbët në Kosovë, atëherë Kosova dhe Shqipëria do të duhej të mbështesin shumë projekte në këto komuna", është shprehur Kurteshi, duke shtuar se tani është koha e fundit që Kosova dhe Shqipëria të bëjnë diçka për shqiptarët e asaj pjese.

**"Epoka e re":** *Z. Kurteshi, së bashku me disa anëtarë të tjerë të komisionit parlamentar që drejtoni ju, keni vizituar Luginën e Preshevës. Cila është gjendja e shqiptarëve atje?*

**Kurteshi:** Si Komision i Arsimit në Luginë të Preshevës kemi qenë edhe në vitin 2015, kurse tani më 5 dhe 6 qershor kemi shkuar një pjesë e Komisionit të Arsimit dhe një pjesë e Komisionit Parlamentar të Administratës Publike. Dhe kur

# teti më i diskriminuar në Evropë

e krahasojmë gjendjen e tanishme të shqiptarëve me gjendjen para katër vjetëve, gjendja tani në Luginë e Preshevës është dukshëm më e rëndë sesa ka qenë para katër vjetëve.

**"Epoka e re":** *Në çfarë aspektesh është më e rëndë?*
Kurteshi: Në shumë aspekte. Për shkak të kushteve të vështira të jetesës, diskriminimit në punësim, mungesës së teksteve shkollore dhe mosnjohjes së diplomave, numri i nxënësve ka rënë dukshëm në të tri komunat e Luginës. Sigurisht se ka rënë edhe numri i banorëve në këto komuna. Prandaj, deri tash ata nuk kanë përjetuar ndonjë përparim në aspektin e përmirësimit të gjendjes së tyre, as nga ato marrëveshjet e nënshkruara në mes të Kosovës dhe Serbisë në dialogun e Brukselit. Atje është nënshkruar edhe marrëveshja për tekstet shkollore dhe për njohjen e diplomave. Shqiptarët e Luginës së Preshevës janë të diskriminuar edhe në aspektin e punësimit. Në krejt administratën e Komunës së Medvegjës janë të punësuar vetëm tre shqiptarë, ndërsa në spitalin regjional të Vranjës, ku rreth 40 për qind e pacientëve janë shqiptarë, është vetëm një shqiptar i punësuar dhe në kadastër e gjeodezi nuk ka të punësuar shqiptarë. Pra, shqiptarët janë të diskriminuar në çdo aspekt. Një formë tjetër e diskriminimit dhe dëbimit të shqiptarëve është edhe shlyerja nga evidenca e s hqiptarëve - mërgimtarë të cilët përkohësisht mund të jenë në botën e jashtme.

**"Epoka e re":** *Cilat janë kërkesat e tyre kryesore që duhet t'i adresojnë institucionet e Kosovës?*
**Kurteshi:** Kërkesa e shqiptarëve të Luginës së Preshevës drejtuar delegacionit shtetëror është që çështja e shqiptarëve të Luginës së Preshevës të bëhet pjesë e dialogut Kosovë - Serbi në Bruksel. Shqiptarët kërkojnë reciprocitet në të drejta. Pra, ato të drejta që i gëzojnë serbët në Kosovë duhet t'i gëzojnë edhe shqiptarët në Luginë. Kërkojnë që të zgjidhet çështja e teksteve shkollore dhe të ndodhë njohja e diplomave. Kërkojnë që në universitetet publike të Kosovës të ketë më shumë studentë nga Lugina. Natyrisht, kërkojnë që Kosova dhe Shqipëria të investojnë në projekte të ndryshme në komunat ku jetojnë shqiptarët sepse, siç thanë ata, nëse Serbia mund të investojë nga 500-600 milionë euro për serbët në Kosovë, atëherë Kosova dhe Shqipëria do të duhej të mbështesin shumë projekte në këto komuna. Pra, shqiptarët e Luginës kërkojnë përkrahje politike dhe kërkojnë përkrahje materiale.

**"Epoka e re":** *Në mbledhjen e fundit anëtarët e Komisionit për Arsim janë pajtuar që të thirret një seancë e jashtëzakonshme parlamentare për shqiptarët e Luginës së Preshevës. Pse është e nevojshme të mbahet kjo seancë dhe kur pritet të mbahet?*
**Kurteshi:** Ne si komision u pajtuam që t'i ndërmarrim disa veprime së bashku. Në pajtim edhe me kryetarin e Komisionit për Administratë, Nait Hasanin. Jemi marrë vesh që të martën e ardhshme, më 25 qershor, të dy komisionet ta mbajnë një mbledhje të përbashkët, pastaj bashkërisht të angazhohemi për hapat e mëtutjeshëm. T'i kontaktojmë të gjithë ministrat, kryeministrin, pastaj të thërrasim edhe një seancë në të cilën do ta nxjerrim një rezolutë, të cilën shpresoj se institucionet e Kosovës do ta respektojnë dhe t'i ndihmojmë shqiptarët e Luginës.

**"Epoka e re":** *Çfarë duhet të përmbajë ajo rezolutë?*
**Kurteshi:** Është e rëndësishme të ceket se shqiptarët në Luginë të Preshevës janë komuniteti më i diskriminuar në Evropë, ndërsa askush prej Kosovës dhe as prej Shqipërisë nuk e ngre këtë çështje në qarqet e BE-së. Serbia po përparon drejt integrimit në BE pa u vënë re se shteti serb po bën diskriminime që janë të paimagjinueshme se gjëra të tilla mund të ndodhin në Evropë. Natyrisht se këto që i thashë nuk është komplet ajo bërthama që duhet të hyjë në rezolutë, sepse janë edhe disa kërkesa të tjera. Qëllimi ynë është që të bëhet një rezolutë përmes së cilës do të fillohet t'u ndihmohet shqiptarëve të asaj pjese. Mjaft kemi bërë deklarime pompoze për vëllezërit tanë atje. Nuk mjafton që ne vetëm të kërkojmë nga ta që të qëndrojnë në trojet e tyre. Atyre duhet t'ua plotësojmë kushtet elementare, pastaj të jetojnë në tokën e tyre dhe të prindërve të tyre.

**"Epoka e re":** *Kemi pasur iniciativa të ndryshme për t'i ndihmuar shqiptarët atje. Më herët presidenti Hashim Thaçi ka kërkuar që në dialog të përfshihet çështja e Luginës. Po ashtu, në Kuvend është folur disa herë për kushtet e rënda të shqiptarëve atje. Çka e dallon tani këtë iniciativë nga ato të mëhershmet?*
**Kurteshi:** Nuk e di si ka për të qenë kjo iniciativë, por e di se fatkeqësia e shqiptarëve të Luginës së Preshevës është keqpërdorur nga shumë politikanë në Kosovë. Presidenti ka pasur mundësi ta ngrehë çështjen e tyre në Bruksel, sepse po bisedon që disa vjet me Serbinë. Ai ka mundur ta bëjë reciprocitetin në të drejta, sepse një gjë e tillë edhe mund të realizohet. Shpresoj që këtë herë do të realizohen projekte konkrete që do të mbështeten nga institucionet e Kosovës dhe që do t'ua lehtësojnë jetën shqiptarëve të Luginës. Po ashtu, shpresoj që çështja e tyre të ngrehet në Bruksel. Së pari duhet që BE-ja të njoftohet për diskriminimin që po u bëhet shqiptarëve, më pas të punohet për trajtimin e barabartë të dy komuniteteve, që shqiptarët atje të trajtohen sikurse serbët këtu.

# Miratohet projektligji për marrëveshjen financiare IPA 2018 që kap vlerën e mbi 94 milionë eurove

**Prishtinë, 18 qershor (ER)** - Ministrja e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, në mbledhjen e qeverisë mbajtur të martën ka mbajtur ekspoze për miratimin e projektligjit për ratifikimin e "Marrëveshjes financiare për IPA 2018 ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian".
Projektligji u miratua nga kabineti qeveritar dhe pritet të ratifikohet në Kuvend para pushimeve të verës. "Programi IPA 2018 përfshin aktivitetet në përafrimin me legjislacionin e BE-së, bursat për një vit të projektit Young Cell Scheme, përkrahjen për të drejtat e njeriut, për komunitetet, për mjedisin, përkatësisht përmirësimin e cilësisë së ajrit duke intervenuar me ndërrimin e filtrave për pastrimin e ajrit në Kosovën B, përkrahjen për menaxhimin e mbeturinave të ngurta në komunat e Kosovës, për ndërmarrësinë, për punësimin dhe përkrahjen për arsimin", ka thënë ministrja Hoxha.
Vlera e programit është 94.7 milionë euro, prej të cilave 90.5 milionë euro financohen nga BE-ja dhe pjesa e mbetur si bashkëfinancim nga Kosova për disa nga aktivitetet. Ministrja Hoxha ka kërkuar ratifikimin në Kuvend të këtij projektligji para pushimeve verore për të hyrë në fuqi marrëveshja. Kështu do të fillonte zbatimi i fondeve të parapara me këtë marrëveshje, të projekteve të planifikuara.



# ShSKUK-ja lehtëson shërbimet për të mbijetuarat nga dhuna seksuale gjatë luftës në Kosovë

Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe Shoqata "Medica" nga Gjakova kanë nënshkruar të martën marrëveshje bashkëpunimi për përmirësimin e shërbimeve dhe kujdesin shëndetësor te gratë dhe vajzat me trauma të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë



EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) dhe Shoqata "Medica" nga Gjakova kanë nënshkruar të martën marrëveshje bashkëpunimi për lehtësimin e ofrimit të shërbimeve mjekësore për kategoritë e personave të cilët janë të mbijetuar nga dhuna seksuale gjatë luftës në Kosovë si për ndikimin mbi politikat sociale në mbështetje të mirëqenies së grave dhe integrimit të tyre në të gjitha fushat jetësore.
Marrëveshjen e kanë nënshkruar drejtori i përgjithshëm i ShSKUK-së, dr. Basri Sejdiu, dhe drejtoresha ekzekutive e "Medica Gjakova", Mirlinda Sada.
Qëllimi i përgjithshëm i marrëveshjes është zbatimi i projektit "Përmirësimi i shërbimeve dhe kujdesit shëndetësor te gratë dhe vajzat me trauma të mbijetuara të dhunës në baza gjinore dhe të dhunës seksuale gjatë luftës së fundit në Kosovë".
Projekti synon forcimin e kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve shëndetësore publike për këtë kategori.
Zbatimi do të fillojë në dy komuna, në atë të Gjakovës dhe të Prizrenit.
Kjo marrëveshje lidhet për një periudhë dyvjeçare, me mundësi vazhdimi dhe hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të saj nga të dyja palët.

# Përfaqësuesit e MPB-së dhe të UNHCR-së takojnë azilkërkuesit në Qendrën e Azilit

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Me rastin e javës kur shënohet Dita Botërore e Refugjatëve, zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, i shoqëruar nga zyrtarë të MPB-së dhe shefi i Zyrës së UNHCR-së në Kosovë, Erol Arduç, takuan azilkërkuesit në Qendrën e Azilit në Magure të Lipjanit. Me këtë rast, zëvendësministri Zeka ka thënë se kjo ditë shënohet në mbarë botën, duke shprehur solidaritetin dhe bashkëndjenjën me rreziqet, vështirësitë dhe problemet me të cilat ballafaqohen refugjatët në mbarë botën. "Në këtë ditë dëshiroj ta ndaj me ju përkushtimin e autoriteteve tona për krijimin e kushteve për azilkërkues dhe refugjatë sikurse në vendet e tjera. Ne kemi punuar dhe vazhdojmë të punojmë çdo ditë së bashku me



UNHCR-në, organizatat partnere të saj dhe me organizata të tjera, në mënyrë që të gjithë së bashku t'ua mundësojmë azilkërkuesve dhe refugjatëve një trajtim me dinjitet dhe të drejtë", është shprehur zëvendësministri Zeka.
Ndërsa shefi i Zyrës së UNHCR-së në Kosovë, Erol Arduç, iu drejtua azilkërkuesve të pranishëm, duke u thënë se qendra në të cilën janë të vendosur ofron kushte shumë të mira. Po ashtu, ai tha se "njerëzit këtu janë të ndjeshëm për situatën e juaj si refugjatë dhe janë mikpritës".
Drejtori i Departamentit për Shtetësi, Azil dhe Migracion në Ministrinë për Punë të Brendshme, Valon Krasniqi, ka theksuar se MPB-ja do të vazhdojë të punojë bashkë me UNHCR-në dhe partnerët e saj, që të jetë një sistem efikas i ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike.
Në këtë vizitë, krahas zyrtarëve nga UNHCR-ja dhe Ministria për Punë të Brendshme, morën pjesë edhe studentë të Fakultetit Juridik, të cilët këtë vit kishin ndjekur ligjërata përkitazi me mbrojtjen ndërkombëtare për refugjatët.
Studentët patën mundësinë ta vizitojnë Qendrën e Azilit dhe të bisedojnë me azilkërkuesit. Me këtë rast, të pranishmit mbollën fidanë në oborrin e Qendrës së Azilit.

## Pritet përkrahje më e madhe e Finlandës për Kosovën për fushën e rinisë

Prishtinë, 18 qershor (ER) - Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kujtim Gashi, ka pritur në takim ambasadoren e Republikës së Finlandës, Pia Stjernvall, me të cilën ka diskutuar për fushën e rinisë, me theks për Zyrën Rajonale për Bashkëpunim Rinor (RYCO), kryesimin e së cilës e ka Kosova, konkretisht ministri Gashi.
Ministri Gashi e ka falënderuar ambasadoren Stjernvall dhe përmes saj popullin dhe qeverinë finlandeze për ndihmën e deritanishme që ka dhënë shteti finlandez për Kosovën, sidomos në fushat që mbulon MKRS-ja, veçanërisht projektet dhe bashkëpunimin në fushën e rinisë.
Ministri Gashi e ka informuar ambasadoren finlandeze për fokusin që MKRS-ja ka për rininë në Kosovë. Ai e ka njoftuar ambasadoren se ka nënshkruar të hënën Strategjinë për Rininë e cila parasheh avancimin dhe rritjen e pjesëmarrjes së rinisë në proceset e tërësishme në Kosovë.
Ministri Gashi, po ashtu, i sqaroi ambasadores Stjernvall se bashkëpunimi rajonal në fushën e rinisë është tejet i rëndësishëm ashtu që gjeneratat e reja të edukohen në një frymë më miqësore dhe në një respekt të ndërsjellë, duke mbizotëruar kësisoj mirëkuptimi dhe mirësjellja kundrejt lokalizmit dhe mosrespektit.
"Kosova mbetet e përkushtuar që rinia e saj të ketë bashkëpunim dhe mirëkuptim me të rinjtë e rajonit. Pres edhe përkrahjen e shtetit të Finlandës në këtë drejtim, sidomos për avancimin e infrastrukturës ligjore", ka thënë ministri Gashi.
Ndërkaq ambasadorja Stjernvall e ka njoftuar ministrin se Republika e Finlandës do ta marrë kryesimin e Bashkimit Evropian dhe me këtë rast do të ketë një bashkëpunim dhe përkrahje më të madhe për Kosovën sidomos në fushat që mbulon ministria.



# Ministria e Shëndetësisë shënon përparim në raportin vjetor të auditimit

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, gjatë konferencës për media mbajtur të martën ka folur rreth të gjeturave të raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të vitit 2018. Ai ka thënë se ky raport tregon një përparim rrënjësor të Ministrisë së Shëndetësisë në krahasim me vitet e fundit. Ndërkaq drejtoresha e USAID-it në Kosovë, Lisa Magno, ka përgëzuar ministrin Ismaili dhe Ministrinë e Shëndetësisë për reformat e mëdha në sistemin shëndetësor dhe përparimin në trajtimin e çështjeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ministria e Shëndetësisë (MSh) ka organizuar të martën një konferencë për media në të cilën janë paraqitur të gjeturat e raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të vitit 2018. Raporti për vitin 2018 mbi pasqyrat financiare vjetore tregon një përparim rrënjësor të Ministrisë së Shëndetësisë në krahasim me vitet e fundit.

Nga 27 rekomandime në vitin 2017, Ministria e Shëndetësisë ka përmbushur shumicën prej tyre. Kjo ka bërë që ZKA-ja ta ndryshojë opinionin për Ministrinë e Shëndetësisë nga një opinion i kualifikuar (shkalla më e ulët e zbatimit) në vitin 2017, në një opinion të pamodifikuar në vitin 2018 (shkalla më e lartë e zbatimit).

Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, në këtë konference për media mbajtur të martën ka thënë se ky përmirësim i opinionit të auditorit ka ardhur si rezultat i punëve të mira që janë kryer dhe luftës së suksesshme kundër korrupsionit. "Ministria e Shëndetësisë ka treguar një përkushtim dhe dinamikë proaktive për implementimin e rekomandimeve të dhëna. MSh-ja ka trajtuar këtë çështje me devotshmërinë më të lartë duke dëshmuar se ndryshimet pozitive në sektorin e shëndetësisë janë të mundshme dhe të qëndrueshme", ka thënë Ismaili.

Nga të gjeturat më të rënda të ZKA-së për Ministrinë e Shëndetësisë gjatë vitit 2017 ka qenë edhe blerja e barnave me çmime abuzive, keqpërdorimi i avancave për udhëtime zyrtare, keqmenaxhimi i projekteve kapitale, furnizimi me barna pa sistem të mirëfilltë të shpërndarjes etj.

Raporti i vitit 2018 tregon një situatë tërësisht tjetër për Ministrinë e Shëndetësisë. "Ne kemi trajtuar me prioritet abuzimin me avanca të pajustifikuara për udhëtimet zyrtare gjatë viteve paraprake, kemi ndalur blerjen e barnave me çmime abuzive dhe kemi hartuar udhëzimin administrativ për rregullimin dhe unifikimin e çmimit të barnave, duke shpëtuar miliona euro të shtetit dhe të qytetarëve, kemi nisur transformimin farmaceutik me mbi 100 barnatore të reja në QKUK për të vendosur një zinxhir të mirëfilltë kontrollues të furnizimit me barna që të sigurohemi që çdo bar të shkojë deri te pacientët", ka thënë ministri Ismaili.

Ai ka falënderuar partnerët ndërkombëtarë për identifikimin dhe luftimin e korrupsionit në institucionet e shtetit. "Për këtë falënderojmë qeverinë amerikane dhe USAID-in për shtytjen dhe mbështetjen në luftën e institucioneve tona kundër korrupsionit!", ka thënë ministri Ismaili.

Drejtoresha e USAID-it në Kosovë, Lisa Magno, ka përgëzuar ministrin Ismaili dhe Ministrinë e Shëndetësisë për reformat e mëdha në sistemin shëndetësor dhe përparimin në trajtimin e çështjeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit. "USAID-i është i lumtur ta theksoj përparimin e madh që ka bërë ministri në sistemin shëndetësor të Kosovës. Kjo ministri ka bërë përparime të mëdha në trajtimin e rekomandimeve që kanë dalë nga raporti i Zyrës Kombëtare të Auditimit të cilat kanë kërkuar një vendosmëri, këmbëngulësi dhe një punë shumë të madhe", ka thënë Lisa Magno, drejtoreshë e USAID-it në Kosovë.

Ajo ka përmendur edhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore për kujdesin e zemrës dhe stentimin në QKUK dhe investimet për blerjen e aparaturave mjekësore. "Por, unë dëshiroj të theksoj arritjen më të madhe që ka bërë kjo ministri, që është Udhëzimi Administrativ për blerjen e barnave me çmime referente. Kjo ka thyer disa monopole që është dashur të thyhen dhe çmimet e barnave janë bërë më të përballueshme për qytetarët", ka thënë Lisa Magno.

Sekretari i përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, Naim Bardiqi, ka thënë se ministria mbetet e përkushtuar që t'i adresojë edhe rekomandimet e tjera të dala nga Zyra Kombëtare e Auditimit. "Ajo që e ka ngritur suksesin tonë ka qenë identifikimi i mangësive në të kaluarën. Koordinimi dhe komunikimi i rregullt në mes të departamenteve brenda institucionit tonë ka sjellë edhe këto rezultate. Më vjen mirë që është shpaguar puna e madhe njëvjeçare e gjithë stafit të Ministrisë së Shëndetësisë", ka thënë sekretari Bardiqi.




## Hyn në fuqi marrëveshja e ekstradimit në mes të Kosovës dhe ShBA-së

PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka bërë me dije se nga zyrtarë të lartë të shtetit amerikan tashmë ka pranuar letrën e nënshkruar nga presidenti i ShBA-së, Donald Trump dhe nga sekretari i Shtetit, Mike Pompeo, përmes së cilës konfirmohet hyrja në fuqi e marrëveshjes së ekstradimit në mes dy vendeve. Tahiri përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se kjo marrëveshje shënon një akt historik në marrëdhëniet dypalëshe në mes të Kosovës dhe ShBA-së dhe është garanci e mëtejme se sundimi i ligjit është i paalternativë dhe lufta kundër krimit do të shkojë deri në fund. "Pesha historike e kësaj marrëveshjeje, me vulën e presidentit Trump, do të lë gjurmë në historinë e shtetndërtimit tonë dhe do ta markojë Republikën e Kosovës në rangun e një vendi, në të cilin prijësit e demokracisë liberale dhe sundimit të ligjit kanë besim të plotë", ka shkruar Tahiri.



# Kodi telefonik shtetëror +383 ende nuk është duke u zbatuar plotësisht

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka organizuar një vizitë të anëtarëve të komisionit parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal gjatë të hënës, në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP), për t'u njoftuar për zbatimin e marrëveshjes së Brukselit lidhur me telekomunikacionin dhe kodin telefonik +383. Në këtë vizitë morën pjesë kryetarja e këtij komisioni Sala Berisha-Shala dhe Muharrem Nitaj, anëtar i komisionit, të cilët takuan kryetarin e bordit të ARKEP-it, Kreshnik Gashin dhe zyrtarë të lartë të këtij institucioni.

Deputetët e Komisionit për Zhvillim Ekonomik shprehën interesimin e tyre rreth zbatimit të marrëveshjes së telekomunikacionit dhe ngecjet në këtë proces, përfitimet e Kosovës nga kjo marrëveshje, sfidat nga operatorët telefonikë për zbatimin e marrëveshjes si dhe funksionalizimin e kodit +383.

Kryetari i bordit të ARKEP-it, Kreshnik Gashi, i ka informuar deputetët lidhur me marrëveshjen e telekomunikacionit të arritur në Bruksel më 2013, e cila është cilësuar si e zbatuar në masë të madhe. Gashi i ka njoftuar deputetët që prej 15 dhjetorit 2016 Kosova ka kodin e saj telefonik +383, duke theksuar se një pjesë e kësaj marrëveshjeje nuk është zbatuar, përkatësisht harmonizimi i frekuencave ndërkufitare si pasojë e mosgatishmërisë së Serbisë.

Më tej. Gashi ka shtuar se që prej vitit 2017 dialogu në mes të delegacioneve lidhur me këtë marrëveshje është ndalur, ndërsa nuk ka pasur asnjë diskutim lidhur me shërbimet postare, pavarësisht se është përcaktuar ndryshe me marrëveshje.

Ndërsa shteti i Kosovës ka zbatuar pjesën e marrëveshjes për dhënien e autorizimit të përkohshëm një kompanie të re serbe për shërbime të telefonisë mobile. Ky autorizim është dhënë në përputhje me kornizën rregullatore të Kosovës, për operim të kufizuar në infrastrukturën aktuale në terren. Në kuadër të kësaj, nga marsi i vitit 2017 ARKEP ka ndërprerë operimin e operatorëve ilegalë në veri.

Sa i përket çështjes së zbatimit të kodit shtetëror të Kosovës +383, kryetari i bordit të ARKEP-it, Kreshnik Gashi, ka njoftuar deputetët se operatorët ekonomikë në Kosovë PTK dhe IPKO janë përballur me sfida në adoptimin e këtij kodi dhe të njëjtit kanë kërkuar disa herë shtyrje të afatit të zbatimit të kodit +383.

ARKEP ka vendosur si afat të fundit për zbatim datën 31 tetor 2018 dhe nga 15 janari 2019 ka filluar shqiptimin e gjobave deri në 10 000 euro për operatorët të cilët nuk kanë zbatuar këtë vendim. Pas sanksioneve të shqiptuara nga ARKEP-i, PTK ka arritur ta zbatojë kodin shtetëror të Kosovës +383 vetëm në një fazë. Edhe pse kodi i Monakos +377 nuk është në përdorim nga ky operator, thirrjet ndërkombëtare vazhdojnë të realizohen nëpërmjet Monakos, siç ka ndodhur para marrjes së kodit shtetëror të Kosovës. Si rezultat i kësaj, PTK-ja shënon humbje dhe nuk përfiton nga kodi telefonik shtetëror për arsye të mospërgatitjeve të duhura teknike.



Vlen të përmendet se të dy operatorët PTK dhe IPKO kanë qenë pjesë e delegacionit për negocimin e marrëveshjes së telekomunikacionit.

Përfaqësuesit e ARKEP-it njoftuan anëtarët e komisionit se lidhur me problemet e kompanisë publike PTK rreth zbatimit të kodit +383 e kanë njoftuar edhe Qeverinë e Kosovës nga e cila kanë kërkuar mbështetje për këtë kompani për tejkalimin e këtyre sfidave.

Edhe operatori IPKO, pas sanksioneve të ARKEP-it, ka filluar zbatimin e kodit +383 më 1 qershor 2019, ndërsa IPKO ka filluar edhe zbatimin e kodit mobil shtetëror E212. Anëtarët e komisionit u zotuan se do ta ngrehin këtë çështje edhe në mbledhjet e komisionit. Kjo vizitë u realizua në kuadër të projektit "Perspektiva evropiane - ndërtimi i konsensusit kombëtar për normalizimin e marrëdhënieve me Serbinë" që përkrahet nga Ambasada Zvicerane në Prishtinë.

# Aeroporti 'Adem Jashari' së shpejti do të bëhet me një aeroplan të ri



PRISHTINË, 18 QERSHOR (ER) - Zëvendësministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit, Rexhep Kadriu, në emër të ministrit Pal Lekaj, të martën ka pritur në takim delegacionin austriak të kompanisë ajrore "Eurowings" dhe "Lufthansa Group". Temë kryesore e këtij takimi ishte rritja e afarizmit ajror dhe fluturimeve, për të cilën kompania "Eurowings" tashmë operon në Kosovë, por që synon stacionimin edhe të një aeroplani të ri në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës si dhe angazhimin e një ekuipazhi vendor.

Me startimin e operimit të këtij aeroplani do të rritet edhe zhvillimi ekonomik i vendit ngaqë do të bëhet i mundur punësimi i të rinjve kosovarë, ku për çdo fluturim do të punësohen nga tridhjetë pjesëtarë ekuipazhi.

Përveç kësaj, në të ardhmen synohet që numri i të punësuarve të arrijë deri në 300, të trajnohen profesionalisht dhe të jenë të gatshëm të punojnë edhe nëpër destinacione të tjera nëpër botë.

Zëvendësministri Kadriu, duke pasur parasysh interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, pohoi se një gjë e tillë, përveçse do të ndihmonte në rritjen e kapaciteteve të resurseve humane të Kosovës, do të luante rol shumë të rëndësishëm edhe në stimulimin e tregut dhe zbritjen e çmimit të aviobiletave.

Në këtë mënyrë MIT-ja do të jetë e gatshme ta mirëpresë çdo kërkesë të parashtruar nga autoritetet austriake si dhe të ofrojë çdo lloj mundësie brenda kompetencave të saj deri në zbatimin e plotë të marrëveshjes me kompaninë në fjalë.

# Funksionalizimi i Dhomës së Posaçme zhbllokon 20-përqindëshin e mijëra punëtorëve

Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë se funksionalizimi i Dhomës së Posaçme zhbllokon 20-përqindëshin e mijëra punëtorëve. Sipas tij, lajm i mirë është që më në fund po fillon trajtimi i 21 mijë lëndëve që kanë mbetur nga privatizimi. "Janë mijëra qytetarë që presin 20-përqindëshin e tyre, disa prej tyre presin pagat në këtë proces, kreditorët presin mjetet e tyre. Puna e kësaj dhome ndikon drejtpërdrejt në ritmin e punës së procesit të privatizimit", ka thënë Tahiri



Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, së bashku me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Skënder Çoçaj, kanë vizituar të martën Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, ku janë pritur nga kryetari i kësaj Dhome, Sahit Sylejmani dhe kryetari i Gjykatës Supreme, Enver Peci.

Gjatë takimit, ministri Tahiri ka deklaruar se për shkak të kompetencës ekskluzive të Dhomës së Posaçme me çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, puna e kësaj gjykate ndikon drejtpërdrejt në dinamikën e procesit të privatizimit, e sidomos te shpërndarja e fondeve në mirëbesim te punëtorët dhe kreditorët e ndërmarrjeve shoqërore si dhe bartja e mjeteve të mbetura te buxheti i Republikës së Kosovës.

Sipas ministrit Tahiri, me Ligjin e ri për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, që tashmë është miratuar në leximin e dytë në Kuvendin e Republikës dhe brenda javës pritet të dekretohet nga presidenti i Kosovës, garantohet vazhdimësia e punës së kësaj dhome pas përfundimit të mandatit të EULEX-it në gjyqësor si dhe shënohet një momentum sa i përket përfitimit të pronësisë në sistemin tonë gjyqësor përmes shkëputjes së përhershme nga gjyqtarët ndërkombëtarë dhe kalimit të kompetencave të plota te gjyqtarë tërësisht vendorë. "Lajm i mirë është që më në fund po fillon trajtimi i 21 mijë lëndëve që kanë mbetur nga privatizimi. Janë mijëra qytetarë që presin 20-përqindëshin e tyre, disa prej tyre presin pagat në këtë proces, kreditorët presin mjetet e tyre. Puna e kësaj Dhome ndikon në ritmin e punës së procesit të privatizimit", ka thënë ministri Tahiri.

Trajtimi i lëndëve, sipas ministrit Tahiri, do t'i zhbllokojë edhe rreth 100 milionë euro të bllokuara në BQK të cilat do të derdhen në buxhetin e Kosovës. Ligji i ri mundëson strukturë të re organizative brenda kësaj gjykate, e cila, përveç se respekton pavarësinë gjyqësore, parasheh përfshirjen e plotë të kësaj gjykate brenda kornizës së kompetencave menaxhuese të Këshillit Gjyqësor i Kosovës, ka theksuar ministri Tahiri. "Nëse gjatë viteve të fundit Dhoma e Posaçme është stërngarkuar me lëndë, e situata më pas është bërë edhe më e pamundur me bllokimin total të punës si pasojë e përfundimit të mandatit të gjyqtarëve ndërkombëtarë, tashmë me miratimin e ligjit të ri nuk ka më asnjë arsyetim për gjyqtarët dhe Dhomën e Posaçme. Tani përgjegjësia bie mbi Gjykatën Supreme dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës, që të siguroheni që pikërisht lehtësimet të cilat ua ofron ligji i ri t'i shfrytëzoni maksimalisht për ta çuar përpara punën e kësaj gjykate, për t'i zgjidhur 21 mijë lëndë që janë në pritje dhe si rezultat për ta përmirësuar jetën e qytetarëve tanë", ka theksuar ministri Tahiri.

# Promovohet kultivimi i boronicës




PEJË, 18 QERSHOR (ER) - Ministrja e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Ziviq, bashkë me drejtorin e Zyrës për Zhvillim Ekonomik në USAID, Brian Martalus, morën pjesë në Ditën Fushore të Boronicës e cila këtë vit u mbajt në fshatin Vitomiricë të Pejës. Në këtë ceremoni të organizuar nga MBPZhR-ja në bashkëpunim me USAID, përpos varieteteve të boronicës së freskët, u prezantuan edhe gjemi, reçeli, si dhe gatesa të ndryshme me përmbajtje nga boronica. Me këtë rast, ministrja Ziviq i përgëzoi kultivuesit e boronicës të cilët kishin ekspozuar prodhimet e tyre në këtë ditë fushore dhe u shpreh se ndihet mjaft e lumtur që fermerët kosovarë çdo vit e më shumë po i shtojnë plantacionet e tyre me këtë kulturë e cila ka vlera të larta krahasuar më shumë vende të rajonit. Ajo theksoi se si MBPZhR-ja është e kënaqur me shtimin e jashtëzakonshëm të fermerëve që kanë përvojë dhe atyre që duan të merren me këtë sektor.

Ndërsa drejtori Martalus ka theksuar se boronicat janë të kualitetit shumë të lartë dhe janë shumë të shijshme. Ai ka thënë se me rritjen dhe zhvillimin e këtij sektori, si dhe angazhimi i fermerëve për t'u marrë me këtë veprimtari tregojnë fuqinë dhe potencialin e sektorit bujqësor në Kosovë.

Vlen të theksohet se mes Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe Misionit të USAID-it në Kosovë, në vitin 2018 u nënshkrua marrëveshje e mirëbesimit për mbështetjen e sektorit të bujqësisë në vend. Përmes kësaj marrëveshje u krijua një program i veçantë për mbështetjen e zinxhirit të vlerave të frutave të imëta dhe bimëve mjekësore dhe aromatike në Kosovë.

# Jashari: Skenderaj dhe Drenica ishin dhe mbetën çerdhe të lirisë



SKENDERAJ, 18 QERSHOR (ER) - Komuna e Skenderajt ka shënuar të martën 20-vjetorin e çlirimit nga forcat serbe. Në kuadër të shumë aktiviteteve për nder të 18 qershorit është mbajtur edhe seancë solemne e Kuvendit Komunal të Skenderajt, e cila ka nisur me një minutë heshtje në nderim të të gjithë atyre që kanë rënë për lirinë e Kosovës.
Kryetari i Skenderajt, Bekim Jashari, ka thënë se rruga drejt lirisë ishte e vështirë. Ai ka deklaruar se kontributi i dhënë jo vetëm nga familja Jashari, por edhe nga të gjitha familjet e tjera, tregon se Drenica dhe Skenderaj janë çerdhe të lirisë. Sipas tij, kryefjala e historisë sonë të lavdishme, e cila iu vuri kurorë sakrificave shekullore, është Shaban, Adem e Hamëz Jashari e shumë burra e gra të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).
Më tutje, Jashari ka thënë se lirisë së Kosovës i kontribuuan edhe shumë shtete mike të Kosovës të udhëhequra nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe NATO-ja. Jashari në këtë seancë solemne ka thënë se si kryetar i Skenderajt do të vazhdojë ta zhvillojë jetën dhe mirëqenien e çdo qytetari të kësaj komune.
Ndërsa kryesuesja e Kuvendit Komunal të Skenderajt, Fatbardha Haliti, ka thënë se në qershorin e vitit 1999 bijtë e bijat e Kosovës kishin dalë rrugëve duke triumfuar për lirinë e fituar. Ajo ka thënë se qershori do të kujtohet gjithmonë si muaj i lirisë, kurse marsi do të kujtohet në histori si muaj i sakrificës.
Në këtë seancë solemne kanë marrë pjesë familjarë të dëshmorëve dhe ushtarë të KFOR-it. Kryetari Jashari, i shoqëruar nga drejtues të drejtorive komunale, asamblistë dhe qytetarë, gjatë ditës së martë kanë bërë homazhe te shtatorja e komandantit legjendar Adem Jashari në qendër të qytetit, në Kompleksin Memorial në Prekaz dhe te varrezat e dëshmorëve në Marinë.



# Latifi: Do të jemi afër rahovecianëve që janë prekur nga vërshimet

RAHOVEC, 18 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se të martën që nga orët e hershme të mëngjesit së bashku me ekipin komunal kanë dalë në terren për t'i parë nga afër dëmet e shkaktuara nga reshjet e dendura që kanë ndodhur të hënën. Ai ka thënë se komuna që drejton do të vazhdojë të jetë afër qytetarëve që janë prekur nga vërshimet. "Sot kam vizituar fshatin Pataqan i Poshtëm, një nga vendbanimet më të dëmtuara nga shiu i rrëmbyeshëm. Komuna do të vazhdojë të qëndrojë afër qytetarëve të prekur nga vërshimet, me të gjitha kapacitetet, në mënyrë që dëmet e shkaktuara të sanohen!", ka thënë Latifi.

# Nënshkruhet kontrata për blerjen e një autoambulance për QKMF-në e Deçanit

DEÇAN, 18 QERSHOR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka bërë me dije se kanë nënshkruar një kontratë për blerjen e një autoambulance për nevojat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKM) në këtë komunë. "Kemi nënshkruar kontratë publike me grupin e operatorëve ekonomikë N. Sh. T., 'Made-Kos: Delfin auto sh. p. k. Prishtinë', për blerjen e autoambulancës për QKMF-në, 'Adem Ukëhaxhaj' - Deçan!", ka thënë Ramosaj pas nënshkrimit të kontratës në fjalë.



# Kamenica anulon koncertin për nder të Ditës së Çlirimit



Kamenicë, 18 qershor (ER) - Është anuluar koncerti kulturor-artistik i paraparë të mbahet për nder të Ditës së Çlirimit të Kamenicës.
Kryetari i kësaj komune, Qëndron Kastrati, ka theksuar se në Kamenicë kanë ndodhur ngjarje jo të mira këto ditë. Ai ka thënë se brenda pak ditëve kanë ndodhur dy aksidente, në të cilët kanë humbur jetën dy persona dhe një nga ta është në gjendje jo të mirë shëndetësore. "Ky rast i rëndë na ka prekur të gjithëve dhe për këtë arsye anulohet koncerti kulturor-artistik, i paraparë të mbahet sonte, për nder të Ditës së Çlirimit të Kamenicës. Uroj që rastet si këta të jenë të fundit për qytetarët tanë dhe të riut që po trajtohet në QKUK i uroj shërim të shpejtë!", ka thënë Kastrati.

## Përfunduan zgjedhjet në fshatrat Gajrak, Damanek, Qypevë dhe Bubël të Malishevës



MALISHEVË, 18 QERSHOR (ER) - Në kuadër të mbajtjes së zgjedhjeve në fshatrat e Komunës së Malishevës janë zgjedhur kryesitë dhe kryetarët në fshatrat Gajrak, Damanek, Qypevë dhe Bubël. Zgjedhjet janë duke u organizuar dhe monitoruar nga komisioni komunal, i formuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës dhe mbahen sipas rregullores për zgjedhjet në fshatrat dhe vendbanimet.
Në Gajrak kryetar i fshatit është rizgjedhur Ilir Gajraku, edhe në Damanek është rizgjedhur Ismet Krasniqi, po ashtu edhe në Qypevë është rizgjedhur kryetar i fshatit Naim Morina, në Bubël kryetar është zgjedhur Ahmet Rrahmanaj.
Në këta katër fshatra procesi i zgjedhjes së kryesive dhe kryetarëve ka shkuar në rregull dhe pa probleme, ndërsa sot, sipas orarit të paraparë, zgjedhjet do të mbahen në fshatrat Panorc, Drenoc, Bellanicë dhe Bardh.

# Mjaft interpretime politike! Presidenti është i Republikës, Republika është e qytetarëve



Shkruan: Prof. Lisen BASHKURTI

Në pështjellimin e sotëm politik retorika propagandistike po përpiqet që ta përkeqësojë situatën duke hedhur në turrën e druve edhe aktin unik publik: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe duke rrezikuar republikanizmin si formë qeverisëse. U bënë thuajse tri dekada tranzicion dhe sërish politika shqiptare nuk ka mësuar se kur duhet të heshtë dhe kur duhet të flasë.
Kur flet Kushtetuta, respektivisht institucionet përfaqësuese dhe garantuese të saj, Gjykata Kushtetuese dhe, në mungesë të saj, presidenti i Republikës, politika lypet të heshtë. Kur flet kriza politike dhe nevojitet dialog e kompromis për zgjidhjen e saj, politika duhet të flasë. Te ne rëndom ndodhë e kundërta.
Politika, e sidomos ajo pjesë që ka përgjegjësinë kryesore qeverisëse të vendit, derdh gjithë proleksitetin e padobishëm dhe të panevojshëm për interpretime kushtetuese dhe vendin e rolin e Presidentit në të. Ndërkohë që heshtë tërësisht për përgjegjësitë e krizës politike që ka shkaktuar vetë, duke mos hedhur asnjë hap për dialog e kompromis dhe duke mos ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e saj. Nuk ka më keq kur politika flet për atë që duhet të heshtë dhe heshtë për atë që duhet të flasë. Në këtë situatë kaotike të shkaktuar nga kriza politika dhe përplasje institucionale, të shkaktuar nga mungesa e Gjykatës Kushtetuese, presidenti i Republikës është i vetmi institucion garantues, mbrojtës dhe interpretues i Kushtetutës. Pranimi i këtij fakti është 'conditio sine qua non' për ta kapërcyer vakuumin institucional të shkaktuar nga sfidat e realizimit të reformës në drejtësi, për ta nxjerrë vendin nga kaosi politik si dhe për mos të humbur momentumin për hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.
Në mjedisin e toksikuar politik, në teatrin e polarizimit të skajshëm dhe midis 'llogoreve' në të cilat janë ngujuar palët kryesore të skenës politike shqiptare, presidenti Meta, me përgjegjshmëri kushtetuese, ekuilibër politik, angazhim qytetar dhe bashkëveprim ndërkombëtar po bën përpjekje maksimale t'i kontribuojë mbajtjes së rendit kushtetues, unitetit politik dhe kohezionit social, mbrojtjes së pluralizmit politik dhe mënjanimit të shkarjes së vendit në regjim hibrid.

## Mbrojtja e Republikës

Në një dalje publike përpara pak ditësh, presidenti Meta deklaroi se "presidenti është i Republikës dhe Republika është e qytetarëve". Nuk ishte një deklaratë e thjeshtë, por ishte thelbi filozofik i kreut të shtetit për t'i mbrojtur vlerat dhe parimet kryesore mbi të cilat ngrihet sistemi politik në Shqipëri. Nga ana tjetër, kjo deklaratë mbartë në vetvete edhe shqetësimin themelor që lypset të na shqetësojë thellë të gjithëve, që lidhet me cenimin e republikanizmit në kohën tonë.
Historikisht, teorikisht dhe praktikisht republika është një formë e qeverisjes, në të cilën shteti drejtohet nga përfaqësues që zgjidhen nga qytetarët. Republikat moderne janë krijuar mbi idenë që sovraniteti bazohet tek populli, organet drejtuese zgjidhen prej popullit, i shërbejnë popullit dhe kontrollohen nga populli. Bazuar në Kushtetutën e ShBA-së përcaktimi i republikësi referohet specifikisht formës së qeverisjes, në të cilën individët e zgjedhur përfaqësojnë trupën qytetare dhe qeverisin bazuar në sundimin e ligjit kushtetutës, duke përfshirë ndarjen dhe balancimin e pushteteve. Në ditët që po përjetojmë këto vlera dhe parime të republikës janë tronditur, nga tranzicioni i zgjatur dhe kaotik, nga politikat anti-institucionaliste, nga mos funksionimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe tendenca për kontrollin politik dhe kapjen e tyre. Cenimi i vlerave dhe parimeve të republikës është kërcënimi më serioz që i kanoset vendit në krizën aktuale, që dëmton shumë rëndë imazhin e Shqipërisë në sy të demokracive të konsoliduar në botë dhe që na largon çdo ditë e më shumë me Bashkimin Evropian, në një kohë që lypet t'i afrohemi çdo ditë e më shumë.

## Mbrojtja e unitetit politik e kohezionit social

Një nga parimet më themelore të Kushtetues së Shqipërisë, për të cilat presidenti i Republikës ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë është ruajtja e unitetit politik dhe kohezionit social të popullit. Uniteti politik dhe kohezioni social i popullit nuk janë të dhënë njëherë e përgjithmonë. Uniteti politik dhe kohezioni social kërkojnë investim të vazhdueshëm. Investimi më i mirë është parandalimi krizave politike dhe sociale, dhe, kur ato ndodhin, është menaxhimi paqësor për zgjidhjen e tyre bazuar në radhë të parë në kushtetutë dhe ligj. Atëherë kur situata e krizës tejkalon parashikimet kushtetuese e ligjore, pra del përtej kuadrit juridik, është emergjente që menaxhimi i krizës të bëhet me dialog dhe kompromis politik, për ta rikthyer sërish vendin në binarët kushtetues dhe ligjor.
Kushtetuta dhe ligji prevalojnë në çdo kohë dhe mbi gjithçka. Ndërkohë dialogu politik është i përhershëm dhe i dobishëm sepse ka të bëjë me sigurimin e parimit mirëqeverisjes të gjithëpërfshirës në politikëbërje dhe vendimmarrje. Ndërsa,kompromisi politik është domosdoshmëri në rastet e përballjes me zgjidhjen e krizave të ndryshme dhe rikthimin e normalitetit kushtetues e ligjor. Ndërhyrjet e vazhdueshme të presidentit Meta kanë qenë evidente qysh në fillimet e përkeqësimit të krizës politike në vend. Meta ka vënë kushtetutën dhe ligjin të parët. Pastaj ka nxitur dialogun politik. E më tej ka bërë thirrje dhe përpjekje për kompromis. Meta i ka sugjeruar mazhorancës të heq dorë nga arroganca e kartonëve, nga mungesa transparencës, nga fryma përjashtimore, nga abuzimi me pozitën e saj dhe të bëjë hapa prapa për t'i hapë rrugë dialogut dhe kompromisit politik, akoma pa e futur vendin në krizë institucionale. Nga ana tjetër, Meta nuk ka hezituar për të apeluar publikisht ndaj opozitës, duke sugjeruar që të vazhdojë aksionin e saj politik në dy dimensione njëherësh: në parlament dhe në aksion qytetarë si dhe duke i sugjeruar kurdoherë evitimin e shfaqjeve të dhunshme. Të dy palët e politikës nuk i kanë konsideruar në kohën dhe në mënyrën e duhur mendimet dhe qëndrimet publike të Presidentit Meta. Atëherë, në këto rrethana ekstremizmi politik, presidentit Meta nuk i mbetej gjë tjetër, vetëm të ndërmerrte hapa konkret për parandalimin e thellimit të përçarjes politike dhe rrënimit të kohezionit social në vend. Palët kishin nevojë për kohë. Presidenti Meta ua dha kohën atyre. Palët politike, kryesisht mazhoranca qeverisëse, por edhe opozita në masën e saj, lypet të shfrytëzojë kohën për zgjidhjen e krizës në vend që të vijojnë rrugën për thellimin e saj. Në këtë moment, për hir të unitetit politik dhe kohezionit social, Meta ka pranuar më mirë të bëhet target goditjesh politike, sesa t'i hapte rrugë përçarjes së popullit dhe përplasjeve sociale.

## Mbrojtja e pluralizmit

Republika është formë qeverisëse që i ka rrënjët te përfaqësuesit e zgjedhur. Prandaj kusht themeltar i republikanizmit janë zgjedhjet pluraliste, të lira dhe të ndershme, gjithë përfshirëse dhe të fshehta. Kriza politike shqiptare duket të jetë para së gjithash krizë e zgjedhjeve. Shqipëria ka pasur probleme serioze dhe të përsëritura me zgjedhjet. Ka pasur edhe kriza serioze të herë pas hershme me to. Vendi ka ndërruar disa sisteme zgjedhore, por problemet kanë mbetur të njëjtat. Në mënyrë të veçantë sistemi politik dhe zgjedhor në Shqipëri hëngri goditje të rëndë me ndryshimet kushtetuese të vitit 2008. Protagonistët e këtij dëmi kushtetues janë aktorë kryesorë të skenës politike aktuale në vend. Ishte vetëm Meta dhe struktura e tij politike, modeste asokohe, që bëri gjithçka kishte për të parandaluar deformimet në sistemin politik dhe zgjedhor në Shqipëri. Protagonistët e kësaj faqeje të zezë kushtetuese në Shqipëri që janë ende kryesorë në skenën politike shqiptare me sjelljen e tyre aktuale po provojnë qartësisht shprehjen popullore sipas së cilës "kush e krijon plagën nuk e shëron atë". Dallueshmërisht nga krizat zgjedhore që vendi ka kaluar gjatë tranzicionit, duke përshirë edhe ato mbas ndryshimeve kushtetuese të vitit 2008, kriza aktuale është më e rënda që është ndeshur deri tani. Kjo krizë lidhet drejtpërdrejt me impaktin negativ të krimit të organizuar në zgjedhjet e vitit 2017. Mpleksja e krimit të organizuar me politikën zyrtare në procesin zgjedhor 2017 ka eksploduar krizën politike në vend, ka pushtuar medien prestigjioze ndërkombëtare si dhe po jep impakte direkte dhe indirekte edhe në marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë, sidomos në procesin e hapjes së negociatave për anëtarësim të vendit në BE si dhe në regjimin e vizave në hapësirën Shengen për qytetarët e Shqipërisë. Pra, situata po bëhet alarmante. Kriza e zgjedhjeve të vitit 2017 në Shqipëri tanimë nga një krizë e brendshme, po shndërrohet në kriza me impakte ndërkombëtare. Dy rrezique serioze kërcënojnë Shqipërinë dhe qytetarët e saj. Shtyrja e hapjes së negociatave për anëtarësim në BE dhe rivendosja e regjimit të vizave për qytetarët shqiptar. Pasojat janë të paparashikueshme.
Përgjegjësia bie mbi organizatorët e zgjedhjeve të vitit 2017 dhe institucionet qeverisëse të dala prej tyre. Rënia e besimit po gërryen gjithçka. Drejtësia po hesht. Media ndërkombëtare po gjëmon. Kambanat bien për ato që kanë veshë. I vetmi zë, i qetë, i përmbajtur, institucional dhe dobiprurës në kaosin retorik aktual është Presidenti Meta. Politika shqiptare lypet ta dëgjojë me durim, vetëpërmbajtje dhe reflektim të thellë mendimin e tij. Palët të heqin dorë nga anatemimi i presidentit. Palët ta drejtojnë gishtin nga vetja e tyre. Të kërkojnë përgjegjësitë por, para së gjithash, të gjejnë rrugë daljen nga kriza. Ajo që u nevojitej palëve, presidenti ua dha: Kohën. Atë që i ndihmon palët, sërish presidenti ua ofroi: Dialogun. Koha është nocioni filozofik më i çmuar. Dialogu është mekanizmi më i vyer e më i dobishëm për zgjidhje paqësore të krizave.
Kaq mund të bëjë një president në kushtet e statusit të limituar kushtetues.

## Merkeli kundër shfuqizimit të sanksioneve ndaj Rusisë



BERLIN, 18 QERSHOR - Kancelarja gjermane Angela Merkel tha se sanksionet e Perëndimit kundër Rusisë nuk do të shfuqizohen derisa sovraniteti i Ukrainës të respektohet plotësisht. "Derisa të bëhet përparim në këtë drejtim, sanksionet nuk mund të shfuqizohen. Ato mund të hiqen vetëm nëse Krimeja i kthehet Ukrainës", tha Merkeli.
Pas takimit me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelenskiy, Merkeli tha se ata gjithashtu diskutuan për marrëveshjen e paqes të arritur në Minsk. Presidenti i Ukrainës, një ditë më parë, gjatë takimit me presidentin e Francës, Emmanuel Macron, u bëri thirrje vendeve të Bashkimit Evropian të mos lehtësojnë presionin ndaj Moskës.
BE-ja ka vendosur sanksione ndaj Rusisë, duke përfshirë ngrirje të aseteve dhe bllokim të marrjes së vizave për individë dhe entitete ruse, pasi Moska ka pushtuar Gadishullin e Krimesë nga Ukraina më 2014 dhe ka mbështetur nga ajo kohë, separatistët në lindje të Ukrainës, në konfliktin që ka lënë rreth 13 000 persona të vdekur.

# Trumpi paraqet kandidaturën për mandatin e dytë

Në Florida presidenti Donald Trump filloi zyrtarisht fushatën elektorale për rizgjedhjen e tij, duke shpresuar se votuesit do ta shpërblejnë në votime vitin e ardhshëm për ekonominë e fortë të vendit



UASHINGTON, 18 QERSHOR - Presidenti Donald Trump fillon zyrtarisht fushatën elektorale për rizgjedhjen e tij në një shtet kyç - Floridë. Presidenti Trump shpreson se votuesit do ta shpërblejnë në votime vitin e ardhshëm për ekonominë e fortë të vendit. Por, ndërsa i afrohemi garës së vitit 2020, anketime të ndryshme tregojnë se ai mbetet jopopullor në segmente të mëdha votuesish. Kjo është zakonisht një shenjë rreziku për një president që kërkon të rizgjidhet.
Air Force One ulet për një miting në Pensilvani, një ndër shtetet kryesore për zgjedhjet e 2020-s, ku presidenti Trump fitoi me vështirësi në vitin 2016. Presidenti Trump e shikon ekonominë amerikane si avantazhin e tij kryesor në këtë fushatë elektorale. "Politika është një botë e çmendur. Por, kur kemi shifrat më të mira të punësimit në histori; kur kemi nivelin më të ulët historikisht të papunësisë; kur kemi, ndoshta, ekonominë më të mirë që kemi pasur ndonjëherë... Nuk di se si mund t'i humbasim këto zgjedhje, apo jo?", u tha mbështetësve presidenti Trump.
Një reklamë e re televizive e fushatës Trump u kujton votuesve arritjet e tij.
Ndërsa shpall zyrtarisht në Florida synimin për të rikandiduar, presidenti Trump duket se është gati të përballet me këdo që mund të shfaqet nga një mori kandidatësh demokratë për president.
Për momentin ish-nënpresidenti Joe Biden kryeson në radhët e demokratëve, ndërsa është përqendruar te kritikat ndaj presidentit Trump. "Në pikëpamjen time, ai është një kërcënim, një kërcënim ndaj vlerave tona thelbësore. Katër vjetët e Donald Trumpit do të shihen si një anomali në historinë amerikane. Tetë vjet do të ndryshonin me themel atë çfarë ne jemi si komb dhe se si na sheh bota", deklaroi Biden.
Të dhënat e anketimeve më të fundit i kanë nxjerrë në avantazh Biden dhe disa kandidatë të tjerë demokratë, në një matje teorike përballë presidentit.
Presidenti Trump hodhi poshtë edhe anketimet e brendshme të fushatës së tij, të cilat, gjithashtu, tregonin se Biden dhe disa kandidatë të tjerë demokratë do të fitonin me diferencë të madhe në disa shtete kyçe.
Por, anketimet në një fazë kaq të hershme për zgjedhjet presidenciale mund të jenë jo të sigurta. "Siç e pamë në vitin 2016, anketimet dhe gara mund të ndryshojnë papritur. Mendoj se presidenti mund të detyrohet ta pranojë realitetin duke thënë se ka mbetur prapa dhe se nuk është hapur sa duhet. Megjithatë është e rëndësishme që demokratët të kuptojnë se anketimet mund të ndryshojnë papritur dhe shpesh nuk tregojnë se si është pozicionuar publiku amerikan", i tha kanalit ABC analisti politik Mattthew Dowd.
Me gjithë ekonominë e fortë, niveli i miratimit për presidentin Trump vazhdon të jetë historikisht i ulët.
Dhe ka mbetur kështu për pjesën më të madhe të presidencës së tij. "Nëse shqyrtojmë vetëm anketimet mund të themi se asgjë nuk ka ndryshuar. Donald Trumpi ka qenë gjatë gjithë presidencës së tij në nivelin nga 30 % deri në mbi 40 % të miratimit", thotë Larry Sabato i Universitetit të Virxhinias. Nga anketimet del se megjithëse presidenti Trump ka mbajtur përgjithësisht të kënaqur bazën e tij politike, atij i duhet t'i gjejë mënyrat për ta zgjeruar këtë bazë në mënyrë që t'i rrisë shanset e fitores.

# Wolters: Raportet ushtarake ShBA-Turqi mbesin pozitive



BRUKSEL, 18 QERSHOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Patrick Shanahan, dhe homologu i tij turk, Hulusi Akar, mbesin të angazhuar në dialog dhe mund të takohen javën e ardhshme gjatë takimit të NATO-s në Bruksel, tha komandanti Suprem i Forcave Aleate të NATO-s në Evropë, Tod Wolters. Gjenerali Wolters tha se raportet ushtarake midis Shteteve të Bashkuara dhe NATO-s mbesin "absolutisht pozitive", pavarësisht prej mospajtimeve për bashkëpunimin ushtarak të Turqisë me Rusinë.
Uashingtoni ka thënë se do ta anulojë furnizimin e Turqisë me aeroplanë luftarakë F-35 nëse ajo vazhdon me blerjen e sistemit rus. Sipas administratës amerikane, sistemi rus përbën kërcënim për aeroplanët amerikanë. Megjithatë, Turqia deri më tani ka dhënë sinjale se do të vazhdojë me blerjen. Presidenti i Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë se pjesa e parë e sistemit rus do të mbërrijë në Turqi në muajin korrik. ShBA-ja ka paralajmëruar sanksione ndaj Turqisë, ndërkaq Ankaraja ka pohuar se do t'u përgjigjet atyre.

## Parlamenti rus voton njëzëri për pezullimin e traktatit bërthamor



MOSKË, 18 QERSHOR - Ligjvënësit rusë kanë votuar njëzëri në mbështetje të një dekreti nga presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, për ta pezulluar pjesëmarrjen e vendit në Traktatin Bërthamor të vitit 1987 (INF). Përmes këtij traktati u mundësia eliminimi i një klase të tërë të raketave.
Parlamenti rus votoi me 417 vota pro kësaj mase të Putinit, ndërkaq një deputet abstenoi. Në shkurt, Shtetet e Bashkuara pezulluan pjesëmarrjen e saj në marrëveshje, duke akuzuar Rusinë për shkelje të paktit pas vendosjes së një sistemi raketash.
Rusia, e mohoi akuzën, por më vonë u kundërpërgjigj me tërheqje nga traktati. Moska akuzon ShBA-në për shkelje të marrëveshjes, një akuzë kjo e kundërshtuar nga Uashingtoni. Traktati i INF-së ndaloi Shtetet e Bashkuara dhe Rusinë nga zhvillimi, prodhimi dhe vendosja e raketave balistike me rreze prej 500 deri në 5 500 kilometra.

# Adele, fanse e Spice Girlsit



Grupi Spice Girls është rikthyer në skenë pas disa vjetëve. Këtë të shtunë ato performuan në stadiumin Wembley të Anglisë. Këngëtarja e njohur Adele ka thënë se është fanse e këtij grupi. Ajo ka qenë në koncertin e tij dhe ka bërë një fotografi me pjesëtaret e grupit. Adele ka thënë se ky grup e ka bërë të qesh dhe të qaj. Gjithashtu, ajo ka shtuar se këto këngëtare janë të mrekullueshme.

# Chris Martin dhe Dakota Johnson i japin fund lidhjes





Chris Martin dhe Dakota Johnson janë ndarë pas 18 muajsh së bashku. Marrëdhënia raportohet se përfundoi muajin e kaluar. Ndarja e tyre i befasoi të gjithë pasi çifti po diskutonte mundësinë e fejesës. "Ata po diskutonin për t'u fejuar, por tani thonë se vendosën të ndaheshin. Kjo ishte një surprizë për të gjithë", ka thënë një mik i tyre për "The Sun". Këngëtari dhe aktorja gjithmonë kanë treguar hapur dashurinë për njëri-tjetrin.



# William Levy ndahet nga bashkëshortja

Aktori i famshëm William Levy është ndarë nga bashkëshortja Elizabeth Gutierrez. Sipas mediave ndërkombëtare, çifti i famshëm i ka dhënë fund martesës gjashtëvjeçare. Thashethemet nisën pasi Williami dhe Elizabetha nuk janë parë më së bashku në ngjarje profesionale apo festime familjare. Aktori dhe modeluesja nuk kanë postuar më fotografi me njëri-tjetrin që nga festimi i ditëlindjes së Williamit në muajin prill. Kjo ka ngritur alarmin se marrëdhënia e çiftit, që janë prindër të dy fëmijëve Christopher Alexander dhe Kailey Alexandra, ka marrë fund.

# Lady Gaga puth muzikantin e martuar në skenë

Lady Gaga pak muaj më parë u nda nga i fejuari Christian Carino. Dhe duket se këngëtarja e ka harruar plotësisht atë. Fillimisht u përfol për një romancë me aktorin Bradley Cooper. Por, së fundmi, një tjetër veprim i saj ka marrë vëmendjen e mediave. Këngëtarja puthi në skenë një nga instrumentistët derisa performonte në rezidencën e saj në Las Vegas. Instrumentisti i trombës është Brian Newman, i cili është i martuar.



E rrallë

## Del në ankand revolveri me të cilin Van Goghu vrau veten



Revolveri me të cilin besohet se Vincent van Gogh vrau veten do të dalë në ankand të mërkurën në Paris. E konsideruar si 'arma më e famshme në historinë e artit', revolveri "Lefaucheux " 7 mm pritet të shitet për 60 000 euro. Van Gogh mendohet se vrau veten me armën pranë fshatit Auvers-sur-Oise në veri të Parisit, ku kaloi muajt e fundit të jetës së tij më 1890.

## BARSOLETA E DITËS



**Në një maternitet dy të porsalindur po bisedonin:**
**- Je djalë apo vajzë?**
**- Djalë.**
**- Ma vërteto.**
**- Sapo të shkoj infermierja do ta tregoj.**
**Sapo ik infermierja, vogëlushi tërheq kuvertën dhe i thotë:**
**- E shikon, kam çorape të kaltra.**

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### Ne ora 16:00 (vikendit ne ora 14:00 dhe 16:00)
### "THE SECRET LIFE OF PETS 2" 3D




I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 26 min

**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Harrison Ford, Patton Oswalt, Eric Stonestreet, Jenny Slate, Lake Bell, Hannibal Buress, Nick Kroll, Dana Carvey, Ellie Kemper, Pete Holmes, Garth Jennings, Bobby Moynihan
**Regjia:** Chris Renaud and Jonathan Del Val




### Ne ora 18:00
### "X-Men; Dark Phoenix"

Aksion/Aventurë/Sci-Fi; 1 orë 53 min

**Rolet:** James McAvoy, Michael Fassbender, Jennifer Lawrence, Nicholas Hoult, Sophie Turner, Tye Sheridan, Alexandra Shipp, Kodi Smit-McPhee, Evan Peters, and Jessica Chastain
**Regjia:** Simon Kinberg

### Në ora 20:00
### "MEN IN BLACK; INTERNATIONAL" 3D,




Aksion/Komedi/Sci-Fi; 1 orë 55 min

**Rolet:** Chris Hemsworth, Tessa Thompson, Kumail Nanjiani, Rebecca Ferguson, Rafe Spall, Laurent Bourgeois, Larry Bourgeois, Emma Thompson, Liam Neeson
**Regjia:** F. Gary Gray

FOTO E DITES



Një avion shihet në afërsi të aeroportit në Frankfurt derisa dielli perëndonte. Fotografia është publikuar te "Zëri i Amerikës".

E jashtëzakonshme

## Foshnja e porsalindur në tren fiton udhëtime falas për 25 vjet



Një grua ka sjellë në jetë fëmijën e saj në tren gjatë udhëtimit nga Ceannt në Heuston. Foshnja ka fituar udhëtime falas me tren për 25 vjetët e ardhshëm. Gruaja e re u detyrua ta lindte vajzën në trenin e Galway-Dublin në Kildare të martën, me ndihmën e disa udhëtarëve në bord. Foshnja erdhi në jetë e shëndetshme.




### Ne ora 22:00
### "M A"

Horror/Triller; 1 ore 39 min

**Rolet:** Octavia Spencer, Juliette Lewis, Diana Silvers, Luke Evans, McKaley Miller, Missi Pyle, Corey Fogelmanis, Gianni Paolo, Dante Brown

**Regjia:** Tate Taylor

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Mbi disa argumente që nuk keni dijeni mbase nuk keni pse debatoni. Vetëm do të tregoni që jeni të painformuar mirë lidhur me tema të caktuara.



**DEMI**
Një ditë e tërë në shoqërinë e vetes suaj sot mund t'ju bëjë veçse mirë. Ju shijon të ecurit në rrugë shpenguar ose vajtja në aktivitete kulturore.



**BINJAKËT**
Edhe pse nuk keni gjithçka nën kontroll, kjo nuk do të thotë që nuk menaxhoni dot punën tuaj. Jeni mjaft korrekt kur bëhet fjalë për profesionalizëm.



**GAFORRJA**
Nuk mund të lejoni që personat tuaj të afërt të jenë neglizhentë me një çështje të caktuar. Falë ndërhyrjes suaj gjërat do të rregullohen.



**LUANI**
Keni shumë gjëra që kanë lidhje me administratën sot për të mbyllur dhe do t'ju duhet ta nisni ditën më herët se zakonisht.



**VIRGJËRESHA**
Nëse doni të vini nën presion personat afër jush ose bashkëpunëtorët, sot do t'ia arrini qëllimit. Nuk është e thënë që kjo sjellje është e mirë.



**PESHORJA**
Njerëzit pranë jush e kanë harruar sa person i bukur jeni në shoqëri sepse ju prej kohësh i jeni shmangur kontaktit me të tjerët.



**AKREPI**
Kushtet komode që keni pasur i keni rifituar kohët e fundit dhe kjo gjë ju pëlqen të zgjasë sa më shumë. Do të kërkoni kontakte të reja.



**SHIGJETARI**
Keni rifituar terrenin e humbur në një çështje personale. Kjo gjë ju ka bërë të bindeni që mjafton pak këmbëngulje dhe mund t'ia dilni.



**BRICJAPI**
Jeni pak të ndrojtur në kontaktin e parë me të panjohurit. Më pas bëheni shumë shpejt protagonist i situatave.



**UJORI**
Nëse nuk doni që dikush t'ju vërë me shpatulla për muri dhe t'ju kërkojë llogari, duhet patjetër të përfundoni atë që keni nisur deri në mesditë.



**PESHQIT**
Ditët e fundit keni hasur në pengesa që nuk ju kanë lejuar të shihni qartë sa i përket gjendjes suaj të rënduar shpirtërore.

# Rikthimi i Kol Idromenos

Fytyra plot jetë e një djaloshi që mban në duart e kryqëzuara një libër, është vetëm një nga dhjetëra tablo që na kujtojnë një prej personazheve të rrallë të pikturës shqiptare, KolIdromeon. Kjo pikturë e realizuar më 1927, vijon të përcjellë ndjeshmërinë e ngjyrave dhe emocionin që fshihet përtej. Më 27 qershor Galeria Kombëtare e Arteve do të sjellë për herë të parë një ekspozitë retrospektivë të Idromenos.Ekspozita prezanton pikturat më të rëndësishme të autorit, si dhe shfaq një përzgjedhje fotografish të shkrepura prej Idromenos në studion e tij dhe në qytetin e Shkodrës.



Piktor, arkitekt, urbanist, skulptor, fotograf , muzikant, skenograf KolIdromeno është themeluesi i shkollës realiste të pikturës shqiptare të shekullit XIX – XX. Ishte djali një marangozi dhe projektuesi me origjinë nga Parga (Çamëri). i cili më 1856 vendoset me banim në Shkodër. Arseni (i jati) dhe Roza Saraçi (nëna) patën dy fëmijë: Kolën dhe ToniaIdromeno. PietroMarubi (piktor,arkitekt dhe fotograf) – një emigrant italian me banim në Shkodër, ka qënë mësuesi i parë i Idromenos. Vizatimet dhe akuarelet e para (të njohura) të Idromenos i përkasin viteve 1871-1874. Në vitin 1875 Idromeno ishte student për gjashtë muaj në Akademinë e Arteve në Venecia, por pas shkëputjes prej saj, nuk largohet nga qyteti dhe qëndroi si ndihmës në studion e një piktori venecian për tre vjet.

Kur u kthye në Shkodër, mori pjesë në lëvizjen antiosmane për pavarësinë e Shqipërisë duke qenë në rrethin e intelektualëve të kohës (poetë e shkrimtarë). Në vitin 1883 realizoi tablonë "Motra Tone" që është dhe vepra e parë e rëndësishme realiste në pikturën shqiptare të periudhës së Rilindjes dhe Pavarësisë. Idromeno ishte një figurë interesante dhe komplekse: i pëlqente muzika, luante në trompë në bandën muzikore të qytetit, realizonte dekoret e shfaqjeve teatrale dhe ishte për disa vjet piktori i karnavaleve (1917 – 1936). Më 1885 hapi studion e tij fotografike në Shkodër "Dritëshkronja e Kolës", më 1912 solli për herë të parë në Shqipëri aparatin për shfaqje filmash duke patur marrëveshje me vëllezërit francezë Lumiere. Idromeno ishte urbanisti dhe arkitekti projektues i mbi 60 ndërtesave publike, sociale dhe vila (projektuar dhe zbatuar nga Idromeno), ndërmjet tyre mund të përmëndim, „Vila e Shirokës" (1925–26), „Centrali elektrik" (1928), „Banka e Shtetit" (1930), „Kinemaja Rozafat"(1935), „Kafja e madhe"(1935) etj. Ekspozoi në Romë, Budapest, Vjenë, Bari, New Jork (gjatë viteve 1898 – 1939).Piktori Idromeno përdori në tablotë e tij një penelatë uniformë koloristike, pa shumë kontraste, duke shpërndarë në tablo një dritë të qetë. Idromenos i pëlqente realizmi fotografik, në tablotë e tij, përveç portreteve të familjes, gjejmë të realizuara portrete të miqve dhe shtresës së pasur të qytetit të tij të veshur me kostumet tradicionale shqiptare. Pas tablove të para me temë fetare "Dy rrugët" (1896), "Fluturimi i Zojës"(1890 – 96) etj. Idromeno pikturoi tema nga historia, jeta dhe zakonet tradicionale të popullit si: "Portreti i Skënderbeut", "Dasma Shkodrane", "Plaku i Postribës", "Oborr shtëpie shkodrane" etj. duke hapur kështu i pari rrugën e pikturës realiste laike në Shqipëri. Idromeno ishte piktori më i rëndësishëm i pikturës realiste shqiptare të gjysmës së pare të shekullit XX. Në Galerinë Kombëtare të Arteve, Tiranë ndodhet dhe koleksioni më rëndësishëm i artistit ndër të cilët mund të kujtojmë: "Motra Tone" (1883(, "Pamje nga Ulqini" (1897 – 1898), "Portreti i së shoqes" (1931), "Portreti i mbesës – Orselina" (1932), "Oborr i shtëpisë shkodrane" (1933). Në Drejtorinë e Përgjithëshme të Arkivave të Shqipërisë,, Tiranë ruhen vizatimet e tablosë "Dasma shkodrane", koleksioni i negativave të tij si fotograf ndodhet në arkivin e Qëndrës Albanologjike, Tiranë. Veprat kryesore të Idromenos duke fillluar nga viti 1954, (kur u përurua Galeria Kombëtare e Arteve, Tiranë) e në vazhdim kanë qenë gjithmonë në linjën ekspozicionale të saj.

Tabloja "Motra Tone" (1883) u realizua nga artisti në moshën 23 vjeçare. Ajo u punua në teknikën e vajit mbi kanavacë dhe paraqiste portretin e motrës së artisitit të veshur me kostumin tradicional shqiptar. Historia e krijimit të tablosë "Motra Tone", sipas studjuesitMikelPrenushi (Monografia "KolIdromeno", jeta dhe vepra, SHB"8 Nëntori",1984), i përket fillimit të muajit janar 1883, kur …"për 7 – 8 ditë me radhë motra Tone e veshur me kostumin kombëtar, pozoi në familjen e babait të saj dhe portreti më vonë qe përfunduar me sukses…", pra përfundoi siç e ka nënshkruar piktori më 2 Febbraio (shkurt) 1883. Nënshkrimin e tablosë piktori e kryen në pjesën e sipërme majtas të tablosë mbi sfondin e errët në dy rrjeshta me kaligrafi dore mjaft elegante: Fillimisht me gërma të një ngjyre të kuqe në portokalli është shkruar emri i tij i plotë në gjuhën italiane: „Nicolo", gërma e parë „A" i emrit të Babait – Arsen dhe mbiemri „Idromeno" dhe në rreshtin e poshtëm me të njëjtën ngjyrë është shënuar data e përfundimit të veprës 1883.

Piktori Idromeno në moshën 23 vjeçare, krijoi për herë të parë në Shqipëri një portret që realizohej direkt nga natyra me model. I ndikuar nga piktura e rilindjes italiane, Idromeno, e vendosi modelin e tij ulur, në pozicion përballë e me duart e ngritura lart duke mbajtur shaminë e bardhë tranparente që i mbështillte kokën. Lëvizja e lehtë e kokës majtas, shikimi i përqendruar diku jashtë anash tablosë dhe mbulimi i paksa i portretit me shami (degermijë), i japin tablosë një „tension" artistik mjaft interesant dhe figurës një bukuri të jashtëzakonshme. Vajza e re që pozonte ishte motra e piktorit Tonia, e cila edhe pse në jetën e përditshme vishej me veshje të modës perëndimore, kishte preferuar të pozonte si model, veshur me kostumin e gruas qytetare katolike shkodrane. Teknikisht Idromeno në tablo kishte përdorur velatura që i japin tablosë freski koloristike, transparencë duke krijuar në këtë mënyrë një tablo me bukuri magjike. Idromeno nëpërmjet qëndrimit të figurës dhe lëvizjeve të duarve të saj e ka kthyer këtë vepër veç të tjerash në një simbol të gjendjes sociale të gruas shqiptare në fundin e shekullit të XIX. Teknikisht penelata e Idromenos në këtë tablo procedon herë me velatura transparente e herë me ngjyra pastoze. Portreti i Tones, e veçanërisht shikimi i saj (sytë) i japin veprës një fuqi psikologjike të veçantë dhe e dallojnë si portretin realist më të bukur në artin shqiptar të shekullit XX. Kjo tablo vlerësohet dhe si dhe një nga kryeveprat e artit realist shqiptar, duke hapur i pari një epokë të re në historinë e artit shqiptar: fillimin e artit laik realist shqiptar. Tabloja "Motra Tone" fillimisht ju dhurua motrës nga artisti e cila ishte e martuar e me dy fëmijë, por pas shtatë vjetësh, pas realizimit të veprës, Tonia fatkeqësisht u nda nga jeta. Piktori e mori veprën dhe e mbajti si kujtim në studion e tij. Vepra „Motra Tone „ u ekspozua për herë të parë për publikun në vitin 1954 në Galerinë e Arteve, në Tiranë.

Në Panairin e Barit (1937) u ekspozuat vepra „Dasma Shkodrane" (e cila u realizua gjatë viteve 1917-1924) dhe më 1939 ajo (vepra) u ekspozua në ekspozitën Ndërkombëtare të NewYorkut (SHBA) dhe kthehet në Shqipëri në vitin 1954 me interesimin e qeverisë Shqiptare (sot ndodhet në fondin e GKA, Tiranë).




Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Short i pamëshirshëm për Feronikelin dhe Prishtinën

Dy klubet më të mira në Kosovë gjatë edicionit 2018/2019, Feronikeli dhe Prishtina, do të marrin pjesë në garat ndërkombëtare: Ligën e Kampionëve dhe Ligën e Evropës. Nëse këto skuadra kanë sukses në ndeshjet parakualifikuese, atëherë kundërshtar do t'i kenë The New Saints, përkatësisht Rangersin



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Skuadra nga Uellsi, The New Saints, mund të jetë kundërshtare e kampionit të Kosovës, Feronikelit, në kuadër të Grupit 3 të raundit të parë kualifikues në Ligën e Kampionëve. Skuadra nga Drenasi në gjysmëfinale të fazës paraeliminatore do të përballet me Lincoln Red Imps e Gjibraltari dhe në rast të fitores do të luajë në finale ndaj fituesit të ndeshjes Tre Pennes-Santa Colomas. Ndeshjet e para gjysmëfinale do të zhvillohen më 25 qershor, ndërsa ndeshja finale, e cila siguron edhe një vend në kualifikimet për Ligën e Kampionëve, zhvillohet më 28 qershor.
Feronikeli është favorit i madh për faktin se të gjitha këto ndeshje do të zhvillohet në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Triumfi i Feronikelit në gjysmëfinale dhe finale do t'i sigurojë përballjen në raundin e parë kualifikues me skuadrën e The New Saintsit, por nëse nuk arrin deri në këtë fazë, garat do t'i vazhdojë në Ligën e Evropës.
Edhe skuadra nënkampione e Kosovës, Prishtina, e ka mësuar kundërshtarin e ardhshëm në garat evropiane. Nëse kryeqytetasit e Kosovës e eliminojnë St Josephin e Gjibraltarit në raundin parakualifikues të Ligës së Evropës, në raundin e ardhshëm i pret një përballje tejet e vështirë. Fjala është për skuadrën që drejtohet nga Stiven Gerrard, Rangers, ku aktivizohet edhe anësori shqiptar Eros Grezda. Ndeshjet e raundit të parë kualifikues zhvillohen më 11 dhe 18 korrik, me Prishtinën, që nëse kalon raundin aktual, do të jetë vendëse në ndeshjen e parë.

## Short i vështirë për Partizanin, i lehtë për Shkëndijën

Shorti i Ligës së Kampionëve ka qenë i pamëshirshëm për kampionët e Shqipërisë, Partizanin. Kjo skuadër përballet në turin e parë me kampionin e Azerbajxhanit, Qarabagun, i cili është një ekip i konsoliduar, që luan prej kohësh në grupet e Ligës së Kampionëve dhe Ligës së Evropës. Ndërsa kampioni i Maqedonisë Veriore, Shkëndija, përballet me estonezët e Nomme Kaljus. Në ndeshjet e Ligës së Evropës tri skuadrat e Shqipërisë: Kukësi, Teuta dhe Laçi kanë mësuar kundërshtarët. Ndeshjet e para do të luhen më 11 korrik, ndërsa ato të kthimit më 18 korrik. Teuta do të përballet me letonezët e Ventspilsit. Kukësi do të ketë një kundërshtar të vështirë siç është Debreceni, kurse Laçi ka punë me Hapoel Ber Shevan.

# Gashi: Kosova të përfaqësohet sa më suksesshëm në Minsk



PRISHTINË, 18 QERSHOR - Ministri Kujtim Gashi priti në takim ekipin e Kosovës i cili do të marrë pjesë në Lojërat Evropiane "Minsk 2019" në Bjellorusi që do të mbahen nga 21 qershori deri më 1 korrik. Numri një i sportit në Kosovë i inkurajoi sportistët pjesëmarrës që të prezantohen sa më suksesshëm në Bjellorusi. "Pjesëmarrja dhe prezantimi i juaj në Bjellorusi nuk është përfaqësim i juaji personal, por është edhe prezantim i shtetit të Kosovës. Suksesi juaj në Minsk është një arritje edhe për ne në përgjithësi. Besoj se ne vendimmarrësit dhe politikëbërësit duhet të mësojmë nga ju sportistët", ka thënë ministri Gashi.
Ndërsa kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, ka thënë se në Minsk po shkojnë jo vetëm për pjesëmarrje, por edhe për të arritur suksese maksimale. Sportistët pjesëmarrës në Minsk e falënderuan ministrin Gashi për pritjen dhe i dhuruan fanellën e ekipit pjesëmarrës në këto lojëra evropiane.

# 'Shpërblehen' të padisiplinuarit në ndeshjet e barazhit

"Epoka e re"

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Komisioni Disiplinor i Shkallës së Parë i Federatës së Futbollit të Kosovës shqyrtoi procedurat e hapura nga mbledhja e kaluar e komisionit lidhur me të padisiplinuarit nga ndeshjet përcaktuese të barazhit. Ky komision e ka dënuar me katër ndeshje moslojë futbollistin e Trepçës '89, Ylber Maloku, i cili në ndeshjen e barazhit e ka grushtuar lojtarin kundërshtar. Me katër ndeshje moslojë për arsye të njëjtë është dënuar edhe mesfushori i Vëllaznimit, Kushtrim Gashi. Dënim më të rëndë komisioni në fjalë i ka dhënë futbollistit të Vëllaznimit, Samir Sahitit. Ky i fundit është dënuar me gjashtë ndeshje moslojë për shkak se e ka fyer dhe i ka sharë drejtuesit e FFK-së si dhe ka tentuar ta sulmojë gjyqtarin kryesor të takimit, Mervan Bejtullahun. Lojtari tjetër i Vëllaznimit, Jeton Dushi, është dënuar me tri ndeshje për manifestim të sjelljeve josportive - të gabuara (fyerje, sharje ndaj gjyqtarëve të takimit dhe Federatës së Futbollit të Kosovës). Në procedurë të hapur mbetet kryetari i KF Vëllaznimi, Agim Cana, kurse drejtori i kësaj skuadre, Ahmet Morina, është pezulluar deri në vendimin përfundimtar. Ndërsa Komisioni Disiplinor ka hapur procedurë disiplinore ndaj KF Vëllaznimi dhe ndaj zyrtarit të këtij klubi, Blerim Mula. Procedurë disiplinore është hapur edhe ndaj skuadrës së Gjilanit. Ndërsa futbollistit të Besës së Pejës, Egzon Gashit, i është tërhequr vërejtja e fundit për shkak se ka dhënë deklarata në portale dhe ka shkruar një status në "Facebook" me të cilin e ofendon gjyqtarin kryesor Mervan Bejtullahun.

FEDERATA E FUTBOLLIT E KOSOVËS FFK

## Krasniqi shkëput kontratën me Dritën




GJILAN, 18 QERSHOR - Futbollisti Festim Krasniqi e ka zyrtarizuar ndarjen me Dritën. Mesfushori i spikatur ka bërë me dije se shumë shpejt do të vendosë për skuadrën e re. "Pas bisedimeve me drejtorin e klubit kemi rënë dakord që me marrëveshje ta shkëpusim kontratën. Falënderoj të gjithë udhëheqësit e klubit, ish-trajnerin, profesor Shpëtim Duron për besimin, tifozët 'Intelektualët' për përkrahjen dhe bashkëlojtarët. Shumë shpejt do t'ju njoftoj për vendimin tim se pjesë e cilit klub do të jem në të ardhmen", ka thënë Krasniqi.
Festim Krasniqi ka luajtur për shumë klube në Kosovë gjatë karrierës së tij, kurse një kohë ka bërë karrierë edhe në futbollin e Shqipërisë.

# Tun Bardhoku, 'mollë sherri' në mes të Prishtinës dhe Vëllaznimit

FC Prishtina e ka transferuar dhe prezantuar Tun Bardhokun si lojtar të lirë, por në anën tjetër KF Vëllaznimi vlerëson se klubi kryeqytetas po vepron në mënyrë të çuditshme për faktin se po bisedon me futbollistin pas 'krahëve' të Vëllaznimit dhe se i njëjti futbollist ka kontratë të vlefshme me klubin nga Gjakova

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 18 QERSHOR - Futbollisti Tun Bardhoku është bërë "mollë sherri" në mes dy klubeve me traditë në futbollin e Kosovës, Prishtinës dhe Vëllaznimit. Skuadra kryeqytetase e transferoi futbollistin nga Gjakova, por i menjëhershëm ka qenë reagimi i KF Vëllaznimit që konfirmon se 25-vjeçari ka kontratë me Vëllaznimin. "Informata se futbollisti ynë Tun Bardhoku ka kaluar te radhët e Klubit të Futbollit 'Prishtina' na ka befasuar për faktin se futbollisti Bardhoku ka kontratë të vlefshme me klubin tonë. Jemi të befasuar edhe me sjelljen e zyrtarëve të klubit Prishtina, të cilët, edhe pse e kanë ditur që Bardhoku ka kontratë me Vëllaznimin, kanë vënë kontakt me futbollistin pa e paralajmëruar fare klubin tonë, që paraqet shkelje të dispozitave të rregullores për transferimin dhe




regjistrimin e lojtarëve të FFK-së", thuhet në reagimin e KF Vëllaznimi.
Skuadra kuqezi ka sqaruar se Tun Bardhoku ka biseduar me kryetarin e klubit, Agim Cana dhe nga i njëjti ka marrë premtimin se nuk do të pengohet nëse i jepet rasti që të angazhohet në ndonjë klub jashtë Kosovës. Ndërsa skuadra e "bardheklatër" konfirmon se Bardhoku është transferuar si futbollist i lirë.
Për faqen zyrtare te FC Prishtina, Bardhoku ka folur si futbollist "bardhekaltër". Ai thënë se e ka zgjedhur Prishtinën për faktin se është ndër skuadrat më të mëdha në vend dhe më e trofeshme. "Thjesht zgjodha Prishtinën për arsye se është ndër klubet më të vjetra dhe më e trofeshmja në vend. Është kënaqësi e madhe që një klub si Prishtina të më ofrojë që t'i shërbej me cilësitë e mia. Po ashtu, ishte edhe zgjidhje e vështirë, sepse kisha edhe një ofertë të mirë jashtë vendit dhe ndërmjet dy opsioneve, vendosa për ngjyrat e Prishtinës", ka thënë Bardhoku, duke shtuar: "Prishtina është klub i madh, ka ekip mjaft cilësor, ka shumë konkurrencë, por unë kam besim se do ta përballoj konkurrencën. Besoj që mund ta rikthejmë titullin e kampionit".

# Shatri: Duam të lëmë gjurmë në shtëpinë tonë

PRISHTINË , 18 QERSHOR - Për herë të parë në Kosovë do të organizohet Kampionati Evropian i Divizionit B (U20) në konkurrencën e femrave. Ky është një nga hapat e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) për masivizimin e basketbollit të femrave në Kosovë. Nga 3 deri më 11 gusht Prishtina do të jetë arena e ndeshjeve të mëdha në Evropianin e basketbollit U-20, ku priten takime shumë interesante, por edhe shumë të rëndësishme, derisa kjo është edhe një provë për Kosovën që organizon një ngjarje kaq madhore.
Përveç organizimit, që është shumë i rëndësishëm, ky do të jetë edhe një test për Kosovën U-20 (femrat) që debuton në gara të nivelit të tillë. Përzgjedhësi i Kosovës U-20 (F), Fidan Shatri, flet për rrjedhën e përgatitjeve. "Në fillim kemi pasur probleme me terminë dhe disa lojtare kanë qenë të ngarkuara në mësime. Presim të na bashkëngjitet Besiana Shala nga Suedia. Ajo është shumë e rëndësishme për




ne. Po mendoj se mund të përgatitemi fizikisht deri në fillimin e kampionatit, edhe pse kemi shumë kundërshtarë të fortë në grup", është shprehur Shatri.
Kosova në Grupin A së bashku me Turqinë, Islandën dhe Kroacinë. "Kemi shumë lojtare nën moshën 18-vjeçare, derisa kundërshtarët kanë lojtare me moshë më të lartë. Gjithsesi për ne është e rëndësishme që kampionati po mbahet në Prishtinë dhe është kënaqësi t'i shohim shtete të fuqishme si Turqia, Kroacia, Islanda në shtëpinë tonë", ka thënë Shatri. "Ideja jonë është të paraqitemi sa më mirë. Duhet të jemi realë dhe të pranojmë se kundërshtarët janë më të fortë. Për shembull, Turqia A ka katër lojtare nga U-20 në ekipin e saj. Sidoqoftë, ne do të angazhohemi maksimalisht. Ideja për ta organizuar kampionatin në Prishtinë është pritur shumë mirë, për ta masivizuar basketbollin femëror në Kosovë dhe të jetë një motiv për lojtaret në Kosovë dhe tifozët t'i shohin yjet në Prishtinë. Edhe shtetet e tjera do ta shohin që vashat tona e duan basketbollin", ka shtuar Shatri.

## SHKURT

### Xhelil Abdullai përforcon Llapin

Llapi ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me qendërmbrojtësin nga Tetova, Xhelil Abdullai, i cili së fundmi ishte pjesë e Renovës. 27-vjeçari ka debutuar te Shkëndija dhe është shpallur kampion në edicionin 2011/12. Nga Shkëndija ka kaluar te De Graafschap në Holandë, e pastaj te MSV Duisburg. Ka bërë karrierë edhe tek Euromilk, ku më pas është rikthyer te Shkëndija. Tash e tre edicione ka qenë pjesë e Renovës, ku në stinorin e fundit është paraqitur në 31 ndeshje.

### Atletico synon transferimin e Xhakës

Mesfushori Granit Xhaka shpesh është kritikuar për paraqitjet me Arsenalin, por kjo nuk e ka penguar trajnerin e Atleico Madridit, Diego Simeone, që të shfaqë interesim për shërbimet e tij. Atletico Madridi synim kryesor e ka Marcos Llorenten nga Real Madridi, por ky transferim duket i vështirë dhe "Mundo Deportivo" raporton se Xhaka mund të jetë futbollisti që mund ta bartë fanellën e skuadrës spanjolle në edicionin e ri.

### Arrestohet Platini

Michel Platini është arrestuar në Francë si pjesë e një hetimi për korrupsion në procesin e përzgjedhjes së Katarit si organizator për Kupën e Botës 2022. Hetimet për përzgjedhjen e fituesit të Botërorit 2022 kanë disa vjet që zhvillohen në Zvicër, Francë, madje në ShBA. Ish-kreu i UEFA-s dhe një prej futbollistëve legjendarë të Francës raportohet se ndodhet në paraburgim në një stacion policor në Nanterres, një lagje e Parisit. Platini, 63 vjeç, drejtoi institucionin më të lartë të futbollit në Evropë nga viti 2007 deri në 2015-n, kur u pezullua nga të gjitha aktivitetet e lidhura me futbollin për shkak të dyshimeve dhe akuzave për korrupsion. Ai dyshohet dhe akuzohet se ka favorizuar dhe ka manipuluar votat në favor të shtetit arab, për t'u përzgjedhur pritës i Kupës së Botës.

### Joshua: Revanshi ndaj Ruizit zhvillohet në nëntor

Anthony Joshua ka bërë me dije se revanshi mes tij dhe meksikanit Andy Ruiz Jr do të zhvillohet në nëntor, pa konfirmuar një datë të saktë dhe vendin se ku do të zhvillohet kjo sfidë. Përballja e parë u zhvillua më 1 qershor në "Madison Square Garden" të Nju Jorkut, me Ruiz që befasoi të gjithë. Ai mundi me "KO teknik" në raundin e shtatë britanikun, duke i marrë titujt kampionë bote në peshën e rëndë (kategoritë IBF, WBO dhe WBA). "Kemi piketuar nëntorin dhe besoj se deri atëherë gjithçka do të jetë gati. Këtë herë nuk do të ketë më surpriza", tha Joshua, me 22 fitore e 1 humbje në karrierën e tij. Gjasat janë që revanshi të zhvillohet në Britaninë e Madhe (Londër ose Kardif).

### Ish-sulmuesi i Brazilit: Kam konsumuar drogë gjatë karrierës sime

